

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7759 E premte 11 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Nga GERON KAMBERI



Referendumi i datës 23 qershor 2016 që u zhvillua në Britani, u shndërrua në një dhimbje koke më shumë për BE dhe qeverinë angleze, pasi gati 52% ...
Vijon në faqen 20

BE dhe sfidat e marrëveshjes Brexit

Opinion i Ditës

Nga ANDI BUSHATI



Argumentimi që i ka bërë Presidenti Meta rrëzimit të kandidatit të Gent Cakaj si ministër i Jashtëm ka nxjerrë edhe njëherë në pah shndërrimin ...
Vijon në faqen 21

Gent Cakaj, si një tender me letra false

PRESIDENTI: I RREZIKSHEM, PUNOI PA CERTIFIKATË SIGURIE. KRYEMINISTRI: NDJESE KOSOVE

META REFUZON ÇAKAJN

Rama: E turpshme, antikushtetuese

• Presidenti kthen kandidatin për ministër të Jashtëm: Bëri deklarata të rrezikshme për kufijtë në Ballkan. Dyshimi, e mori certifikatën e sigurisë brenda ditës pasi u emërua në krye të diplomacisë

• Rama fyerje kundër Metës: Vendim i turpshëm, paturpësisht merresh me fjalë, nivel skandaloz, i frikshëm, ai i mijë herë më i ditur se ti, turpëron presidencën, çfarë marre!, si dëshmitari X, etj



Vijon në faqen 2 (Në foto:) Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

RAMA NUK TERHIQET, E PREZANTON GENT ÇAKAJN NE PRITJEN E TRUPIT DIPLOMATIK



Në faqen 3

PAGA E 13

Qeveria shpërblen komisionerët e vetingut me një rrogë për festa

Në faqen 6

MOTI I FTOHTE

Ngricat 'paralizojnë' vendin, mijëra banorë izolohehen në zonat e thella

Në faqen 7

ARSIMI I LARTE

Studentët ngujohen nëpër fakultete: Nuk tërhiqemi, bojkoti vazhdon

Në faqen 8

GJYQTARI ABUZUES

Psikologjia për skandalin e Fierit: Perversiteti po përdor korrupsionin

Në faqen 11

Dosja e prokurorisë/ I plagosuri në Laprakë Erjon Benga: Si na qëllloi me armë Robert Përpepaj

Debatimi para krimit: Jam çun, ngaçmoj çdo vajzë

I fejuari i Griseldës i tha 19-vjeçarit vrasës të mos e shqetësonte më, mori refuzim

TIRANË - Dy javë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në zonën e Laprakës, ku mbeti e vrarë 17-vjeçarja Griselda Gjikalaj dhe u plagosur Erjon Bengaj, "Gazeta Shqiptare" ka siguruar dosjen e plotë të prokurorisë në lidhje me krimin që tronditi kryeqytetin. Në

këtë dosje jepet dinamika e plotë e ngjarjes që nga përndjekja e vajzës me origjinë nga Kurbaneshi i Mirditës nga 19-vjeçari Robert Përpepaj, shërri me Erjon Bengën, mik me të fejuarin e viktimës e deri te përgatitja e atentatit nga autori dhe bashkëpunëtori i tij, Ronald



Muzhaqi. Atentat ky i ndodhur mbrëmjen e 26 dhjetorit të vitit që shkoi në vendin e quajtur "Pallatet Gintash" në Laprakë. Referuar dokumentit zyrtar, rezultoi se e mitura është qëlluar me dy plumba në kokë nga i dyshuari Robert Përpepaj ...

Në faqen 10

ÇESHTJA "CAKAJ" PRESIDENTI

Presidenti i kthen kryeministrit ministrin e Jashtëm: I papërgjegjshëm

Meta refuzon Cakajn ministër: I rrezikshëm, pa certifikatë sigurie

"Përkrahje e ndryshimit të kufijve, destruktive"

Presidenti Ilir Meta ka refuzuar të dekretojë emrin e Gent Cakajt, propozim i kryeministrit Edi Rama, në postin e ministrit të Jashtëm.

Në arsyetimin e tij, Meta thekson se Cakaj ka aplikuar për certifikatë sigurie pranë ministrisë vetëm më datë 03.01.2019, edhe pse përmbushja e këtij detyrimi fillon nga marrja e detyrës si zëvendësministër i MEPJ.

"Procesi i verifikimit, i kryer në këtë rast nga (DSIK) si Autoriteti i Sigurimit Kombëtar në Shqipëri është realizuar brenda 1 (një dite) që referuar fakteve, dhe të dhënave të Gent Cakaj, tregon qartë se nuk është kryer një proces i mirëfilltë verifikimi sipas kushteve, detyrimeve, kritereve dhe procedurës së parashikuar në Rregulloren e Sigurimit të Personelit, miratuar me VKM nr. 188, datë 04.03.2015," thekson kreu i shtetit, ndërsa nënvizon se prej 7 muajsh ka neglizhuar qartësisht zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, që sipas parashikimeve të ligjit përbëjnë shkelje penale dhe janë të dënueshme sipas legjislacionit në fuqi.

"Sipas konfirmimit shkresor të MEPJ dhe DSIK, z. Gent Cakaj ka plotësuar formularin e aplikimit vetëm më datë 03 janar 2019 (3 ditë pas firmosjes së propozimit për dekretim të ministrit të MEPJ)", thuhet në arsyetimin e kreu të shtetit.

ARGUMENTIMI I KREUT TË SHTETIT

Zoti Kryeministër, Gjatë ushtrimit të detyrës së tij si zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Gent Cakaj ka dëshmuar me të dhëna, me fakte e qëndrime se jo vetëm që i mungon përvoja e provuar në fushën e politikës së jashtme, por se qëndrimet e tij publike lidhur me çështje thelbësore të politikës rajonale janë të papranyshme.

Qëndrimet e tij publike në kontekstin e debatit për të ashtuquajturin korrigjim të kufijve të Kosovës e Serbisë,



Gent Cakaj

por edhe të Ballkanit Perëndimor janë në kundërshtim të plotë me programin e qeverisë aktuale për politikën e jashtë dhe shtjellimin e saj nga Ministria e Punëve të Jashtme (citohet nga intervista e zv/ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, për emisionin "Zona e Debatit" në Klan Kosova, dt. 01 nëntor 2019:

"...Tani të korrigjimi i kufijve semantiksht kjo nuk është thjeshtë një operacion lingvistik për ta relativizuar çështjen e këmbimit territorial, por situata ka evoluar tutje. Evoluimi i parë është, sepse po konceptohet në suaza të korrigjimeve të përgjithshme territoriale që janë duke ndodhur në Ballkanin Perëndimor..."

Këto deklarata të rrezikshme të z. Gent Cakaj, me pasojë të paparashikueshme në rajon dhe me gjerë, në planin dypalësh dhe më tej, janë në kundërshtim të hapur me politikën rajonale të shtetit shqiptar, të NATO-s dhe të vetë Bashkimit Evropian.

Përkrahja, sponsorizimi apo dhe mosreagimi me vendosmëri ndaj tezave për shkëmbim territoresh/korrigjim kufijsh në rajon është gjasje destruktive që kërcënon paqen dhe sigurinë e rajonit dhe në mospëruajtje me angazhimet e detyrimit e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s dhe minon besueshmërinë e vendit tonë si faktor

stabiliteti në rajon.

Zoti Kryeministër, Nga informacioni i administruar mbi verifikimin e sigurisë dhe pastërtisë së figurës, Presidenti i Republikës ju bën me dije se:

1. Z. Gent Cakaj ka treguar mungesë të theksuar të përgjegjshmërisë gjatë ushtrimit të detyrës së zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, duke neglizhuar zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore që garantojnë kualifikimin e sigurt të informacionit të klasifikuar sekret shtetëror.

Konkretisht z. Gent Cakaj me VKM nr.342, datë 07.06.2018 është emëruar në detyrën e zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ushtrimi i së cilës kërkon domosdoshmërisht pajisjen me certifikatën e sigurisë personale, me qëllim që personi të njihet, administrojë apo përpunojë informacion të klasifikuar.

Nga ky moment subjekti në fjalë, në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror", i ndryshuar VKM nr. 188, datë 04.03.2015 "Për miratimin e rregulloreve për sigurimin e personelit", VKM nr. 836, datë 14.10.2015 "Për miratimin e rregulloreve për punën me informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe Bashkimit Evropian" dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre, të nxjerra nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme,

PERVOJA DIPLOMATIKE

"Profili i z. Gent Cakaj, i propozuar për postin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, ka mungesë të qartë të përvojës politike, diplomatike, administrative, shtetërore, në secilin element dhe në tërësi", - shkruan Meta.



Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

04.03.2015, ku parashikohet se verifikimi i sigurisë fillon vetëm pasi individit aplikues ka pranuar dhe ka dhënë pëlqimin me shkrim, pavarësisht se funksioni dhe detyra që ai ka ushtruar e kishte të domosdoshme dhe të detyrueshme nevojën për njohje me informacionin të klasifikuar.

Shmangia prej tij i zbatimit të këtyre detyrimeve ligjore, së pari është shkelje për të cilën çdo funksionar duhet të mbajë përgjegjësitë që i takojnë, por njëkohësisht kjo sjellje tregon për mungesë të përgjegjshmërisë në ushtrimin e funksionit publik si zvmnistër për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe është një tregues tepër i qartë për rrezikun që mbart kjo kandidaturë, për të ushtruar detyrën shumë të rëndësishme të propozuar për emërim të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

2. Procesi i certifikimit të sigurisë për z. Gent Cakaj i kryer nga DSIK brenda një dite (04.01.2019), duket hapur që është një proces i kryer në kushtet e urgjencës, dhe në kundërshtim me procedurën dhe kërkesat e ligji nr. 8457, datë 11.02.1999 "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror", i ndryshuar VKM nr.188, datë 04.03.2015 "Për miratimin e rregulloreve për sigurimin e personelit".

Në formën se si është kryer, procesi i verifikimit të sigurisë për z. Gent Cakaj nuk garanton besueshmërinë e duhur të Certifikatave të Sigurisë të lëshuara nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK). Nga informacioni i administruar rezultojnë se i gjithë

procesi për verifikimin dhe vlerësimin e sigurisë për të përcaktuar nëse z. Gent Cakaj, është një individ besnik, i besueshëm dhe i sigurt që vërteton nga pikëpamja e sigurisë se ai i plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar, është realizuar në më pak se 24 orë.

Ky veprim tregon qartë se procesi i verifikimit, nuk është kryer i plotë, nuk është objektiv, por i ndërmarrë vetëm për përmbushjen procedurale (jo përmbajtësore) të informacioneve shtesë që do të mund të kërkonte Presidenti i Republikës në funksion të verifikimit kushtetues për shkak të procesit të emërimit të këtij shtetasi në detyrën e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Zoti Kryeministër,

Për sa u përshtrua më sipër:

Kandidatura e z. Gent Cakaj nuk i plotëson kushtet, nuk krijon besueshmëri dhe nuk ofron garancitë e nevojshme për ushtrimin me objektivitet dhe në lartësinë e kërkuar të detyrës tepër të rëndësishme të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Në këto kushte, Presidenti i Republikës, në përmbushje të detyrimeve kushtetuese si Kreu i Shtetit, si Kryetar i Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe rolit të tij specifik kushtetues në politikën e jashtme të shtetit shqiptar,

refuzon propozimin tuaj nr. 6174 prot., datë 31.12.2018, për emërimin e z. Gent Cakaj, në detyrën e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Kreu i qeverisë ka sulmuar ashpër presidentin: Genti, 1 mijë herë më i ditur se ti

Cakaj, sërish te Meta për ministër. Rama: E sulmojnë se është i pastër

“Refuzimi, jo vetëm antikushetues, po edhe i turpshëm”

Gent Cakaj do jetë sërish propozimi i kryeministrit Edi Rama për të qenë ministër i Europës dhe Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Pavarësisht refuzimit që i bëri dje Presidenti i Republikës, Ilir Meta, Rama pritet t'i çojë sërish Cakajin si kandidat për ministër. Këtë e la të kuptojë dje në mbledhje vetë kryeministri gjatë takimit të përvitshëm me diplomatët e huaj të akredituar në Tiranë, ku nuk iu shmang as debatit për kandidaturën e Cakajit. “Më vjen keq që i ardhuri ynë nga Prishtina e ka nisur rrugëtimin e tij si ministër në pazakonshtëri. Paragjykimet, balta dhe mllafi i injorantëve kanë bërë që të gjykohej pa e hapur ende gojën”, - u shpreh në fjalën e tij. Ndërkohë që ka sulmuar presidentin se iu kthye avazit të vjetër, ai ka mbrojtur propozimin e tij për ministër të Jashtëm, ndërsa ka theksuar se ai sulmohet vetëm sepse është i pastër. Rama sqaroi edhe njëherë se argumenti që ka përdorur kreu i shtetit është Cakaj ka mbrojtur idenë e ndryshimit të kufijve me Kosovës dhe Serbisë nuk qëndron. “E kanë sulmuar dhe shkelur dinjitetin e tij, sepse është i pastër dhe nuk i përket llogaritjeve të vjetër. Sepse nuk mund të akuzohet për asgjë. Sepse është shumë i pastër, se si kosovar nuk mund të bëhet ministër. Unë nuk kam zgjedhur Gent Cakajin, as si kosovar, as si i ri, por si një shqiptar evropian. Fillimisht ia nisi si këshilltar dhe më pas si zvmministër. Ai kurrë nuk ka shprehur asgjë që bie ndesh me politikën tonë të jashtme. Kush e thotë ose është keqdashës, ose është keqlexues. S’ka predikuar kurrë ndryshime kufijsh në Ballkan e as ka ndërrhyrë në një çështje si ajo e Kosovës dhe Serbisë”, - tha Rama.



Kryeministri Edi Rama, dje gjatë pritjes me ambasadorët e huaj

META
“Pavarësia, integriteti territorial i Kosovës dhe vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë janë të padiskutueshme për Republikën e Shqipërisë deri në sekondën e fundit si president i vendit tim”.

DEKLARATA



PËR KUFIJTË

“Ai kurrë nuk ka shprehur asgjë që bie ndesh me politikën tonë të jashtme. S’ka predikuar kurrë ndryshime kufijsh në Ballkan e as ka ndërrhyrë në një çështje si ajo e Kosovës dhe Serbisë”, - tha Rama.



ARGUMENTET

“Refuzimi është jo vetëm antikushetues, po edhe i turpshëm. Argumentet e dhëna nga zoti president janë të frikshme për nivelin skandaloz dhe turpëruese për institucionin. Ndjesë Kosovës për këtë turp”.



PËR TAHIRIN

“Ah edhe Edita Tahiri, bashkuar me ca qyqarë që salutojnë vendimin e vizionarit IM! Genti, e dashur Edita, i meriton sulmet tuaja aq sa këta ‘vizionarë’ emrin njeri! Po ti xhan?”



Shqipëria do të hapë në pranverë kufijtë me Kosovën

Në fjalën e tij para trupit diplomatik, kryeministri Edi Rama ka bërë të ditur se përveç ngritjes së një pike të përbashkët doganore, kufijtë mes Shqipërisë dhe Kosovës do jenë thjesht një nocion formal. Kjo pasi ai bëri të ditur se në pranverë kufijtë mes Kosovës dhe Shqipërisë do të hapen sipas modelit të vendeve të zonës “Shengen”. “Ne jemi përgatitur dhe në pranverë do të hapim kufirin me Kosovën. Por dëshirojmë që askush të mos e deformojë qëllimin dhe përmbajtjen e këtij akti, duke ricikluar përsëri atë vazhden e mbetjeve të folklorizimit të së shkuarës. Ne kemi marrë gjithë regjimin ‘Shen-



gen’, e kemi përkthyer dhe i kemi nënshtruar një procesi teknik shumë të detajuar për të garantuar të gjitha elementët e sigurisë dhe për të garantuar një nivel lëvizjeje që sot është absurd”, tha Rama. Më tej kryeministri ndërsa siguroi se kjo nuk duhet parë me panik nga fqinjët

e tjerë, theksoi se e njëjta gjë do të synohet të bëhet edhe me Maqedoninë dhe Malin e Zi. “Qëllimi ynë është me shumë se kaq. Ne këtë duam ta bëjmë edhe me Maqedoninë dhe këtë e kam folur edhe me kryeministrin Zaev. Këtë duam të bëjmë edhe me Malin e Zi”, - shtoi Rama.

nga Presidenti i Republikës janë jo vetëm turpëruese për Institucionin e Presidentit, por edhe të frikshme. “Refuzimi i presidentit për dekretimin e ministrit të ri për Europën e Punët e Jashtme është jo vetëm antikushetues, por edhe i turpshëm. Argumentet e dhëna nga zoti president janë të frikshme për nivelin skandaloz dhe turpëruese për institucionin. Ndjesë Kosovës për këtë turp”, - shkroi sërish Rama.

njeri. “Ah edhe Edita Tahiri, bashkuar me ca qyqarë që salutojnë vendimin e vizionarit IM! Ah çfarë llumi, mllafi e terri që ‘vizionarët’ e kësaj kategorie e jashtëqesin si lumë dashurie për kombin! Genti, e dashur Edita, i meriton sulmet tuaja aq sa këta ‘vizionarë’ emrin njeri! Po ti xhan?”, - shkroi sërish Rama.

META

Por pas këtyre sulmeve ka ardhur edhe reagimi i kreut të shtetit, i cili po nëpërmjet një komenti në rrjetet sociale, i kujton Ramës se pavarësia dhe integriteti territorial i Kosovës do të mbeten prioritarë për Shqipërinë për sa kohë ai do jetë president. “Pavarësia, integriteti territorial i

Kosovës dhe vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë janë të padiskutueshme për Republikën e Shqipërisë deri në sekondën e fundit si president i vendit tim”, - bëri të ditur Meta në reagimin e tij. Por nuk ka mbaruar me kaq, pasi në një tjetër kundërpërgjigje, Rama do të theksonte se Meta merrej me fjalë. “Që presidenti ynë të shkelë Kushtetutën, godasë qeverinë, nëpërkëmbë një djalë të ri e të paktën 1000 herë më të ditur se ai, duke u marrë paturpësisht me fjalë si të ishte Dëshmitari X...Oh çfarë marre! IM me qyqarët e kadrinjtë mbrojnë Kosovën nga një shqiptar i Kosovës. Pupupu”, - shkroi Rama në një tjetër reagim.



Pritja e diplomatëve, Rama merr në takim edhe Gent Cakajin

Kryeministri Edi Rama ka pritur dje në një takim të veçantë të gjithë trupën e diplomatëve të akredituar në vendin tonë për t’i uruar Vitin e Ri. Ai e ka shfrytëzuar këtë takim edhe për të përcjellë disa mesazhe që i shkojnë për shtat edhe debatit të brendshëm politik. Rama është kujdesur që në këtë takim të kishte në krah ministrin e Jashtëm në ikje Ditmir Bushati, për të cilin nuk i kurseu fjalët e mira, ashtu edhe ministrin e ri të propozuar, Genti Caka. “Ju sot erdhët këtu, gjetët një qeveri të re, por një Shqipëri të njëjtë dhe me avazin e Presidentit të Republikës. Ai nuk pranoi të dekretonte një ministër të Jashtëm, por unë nuk e parashikoja dot këtë fakt”, - tha Rama.

DEBATI

Menjëherë sapo kreu i shtetit publikoi dje vendimin e tij të refuzimit shogëruar edhe me argumentet përkatëse, kryeministri Edi Rama larg çdo komunikimi etik dhe institucional, siç është përpjekur të jetë deri më sot në raport me Institucionin e Presidentit, ka bërë një sërë reagimesh të ashpra me objekt pikërisht Presidentin e Republikës. Në reagimin e tij të parë, ai e konsideroi si të turpshëm refuzimin e Metës dhe mbi të gjitha, antikushetues. Sipas tij, argumentet e dhëna

ÇESHTJA "CAKAJ" REAGIMET

Salianji: Vendimi Metës për Cakën është kushtetues derisa të shprehet gjykata

Meta refuzoi Cakajn, PD: Ka vetëm një rrugë, Rama të dorëhiqet

Shehu: Kanë rënë kolonat që mbajnë një qeveri

Valentina Madani

Opozita shprehu dje mbështetjen për vendimin e Presidentit, i cili refuzoi të firmosë Gent Cakaj në krye të ministrisë së punëve të jashtme. Ish-ministri i Jashtëm Tritan Shehu, i ftuar në rubrikën "Opinion" në News24 deklaroi se e vetmja zgjidhje do ishte që kryeministri Rama të japë dorëheqjen dhe të nisë organizimin e qeverisë nga e para. Shehu u shpreh që refuzimi i Metës për Cakën ishte i argumentuar, ndërsa shtoi se kjo përgjigje ishte një shuplakë për të gjithë argatët që kërkojnë copëtimin e Kosovës. "Në vendet tjera do kishte vetëm një rrugë, ajo e dorëheqjes së kryeministrit. Në çdo vend ku funksionon demokracia ka vetëm një rrugë, kryeministri të japë dorëheqjen. E vetmja hapësirë që ka kryeministri pas asaj që ndodhi është dorëheqja e tij. Këtu kanë rënë e gjithë qeveria, çështjet në mbrojtjet e interesave tona. Pra, kanë rënë kolonat që mbajnë një qeveri në çdo shtet demokratik. Ka vetëm një rrugë, të bjerë qeveria. Presidenti, unë e lexova materialin, nuk jam jurist, unë e shoh në kuadrin politik, ishte e argumentuar. Unë shoh që ka përplasje mes linjave konceptive dhe filozofive, tani mund të hapet një proces i ri. Në qoftë se dikush kërkon të krijojë trazira në rajon, qoftë mbajtjen e vendeve larg BE, shkojmë në procese që dëmtojnë rëndë interesat kombëtare, siç është bërë shpesh gjatë Rilindjes", deklaroi z. Shehu. Edhe deputeti i PD-së, Ervin Salianji, në një postim në një postim në 'Facebook', ka reaguar në lidhje me mosdekretimin e Gent Cakajt si ministër i Jashtëm nga Presidenti Ilir Meta. Salianji shkruan se Rama dhe DSIK i kanë dhënë certifikatën e sigurisë aplikuesit zëvendësministër që nuk e ka marrë për muaj me radhë certifikatën. Ndërsa më tej shton se "për deputetët e Komisionit të Sigurisë Kombëtare u



Ish-ministri i Jashtëm Tritan Shehu

TRITAN SHEHU

"Unë mendoj që ka vetëm një rrugë, dorëheqja e kryeministrit. Këtu kërkohej rikompozimi i qeverisë, pas rrezimit të kryeministrit. Kjo është historia, nuk ka nevojë për diskutim politik dhe moral. Ishte një shuplakë për të gjithë argatët që kërkojnë të copëtojnë Kosovën", tha deputeti i PD-së.

Gjoshja: Cakaj kandidaturë qokash, reagimi i Ramës i turpshëm!

Ish-ministria e Integritetit, Klajda Gjoshja deklaroi dje se kandidatura e Gent Cakaj si ministër i Jashtëm, është një kandidaturë qokash, ndërsa e konsideron të turpshëm reagimin e kryeministrit Rama kundër Ilir Metës dhe Edita Tahirit. "Sa turp për një Kryeministër të shprehet me një gjuhë të tillë si për Presidentin e Republikës, ashtu edhe për një zonjë të nderuar të Kosovës, si Edita Tahiri. Pasi rrethoi imazhin dhe funksionalitetin e Ministrisë tonë të Jashtme me kandidatura qokash, tani përpiqet t'i kundërvihet sipas edukatës së tij gjithkujt që respekton Shqipërinë, pavarësinë e Kosovës dhe kufijtë e saj! Çdokush që mendon se



mund të përdor vendet tona për interesa të ngushta personale, është vetëm një naiv që do të ketë një fund të dhimbshëm! Diplomacia është art i komunikimit, është mishërimi i eksperiencës dhe maturisë, dhe mbi të gjitha është besimi që qytetarët kanë të

mbrojtja e interesave kombëtare! Diplomacia nuk është numri i librave të lexuar dhe as përdorimi i individëve për larje hesapësh, e për destabilizim të një rajoni të brishtë si ky ku ne jetojmë", tha ish-ministria e integritetit.

deshën 5 muaj verifikime dhe konfirmime nga të gjitha institucionet e sigurisë kombëtare, madje disa deputetëve të Rilindjes nuk u dha kjo certifikatë nga DSIK". Po ashtu deputeti demokrat shton se Rama po qeveris në tejkalim të ligjit dhe Kushtetutës dhe shton se vendimi i Presidentit të Re-

publikës është kushtetues derisa gjykata të shprehet. "Rama dhe DSIK (institucion në vartësi të tij) i jep certifikatën e sigurisë brenda një dite aplikuesit zëvendësministër që nuk e ka marrë për muaj me radhë certifikatën! Ndërsa për deputetët e Komisionit të Sigurisë Kombëtare u deshën 5 muaj verifikime

dhe konfirmime nga të gjitha institucionet e sigurisë kombëtare, madje disa deputetëve të Rilindjes nuk u dha kjo certifikatë nga DSIK. Situata është edhe më delikate kur shtetas ka jetuar për periudhë të gjata kohore jashtë Shqipërisë dhe akoma më delikate kur flitet për ndryshim kufijsh që cen-



Kryeministri Edi Rama gjatë një takimi me ministrat

EDMOND HAXHINASTO

"Duket se i vetmi filtër kontrollues mbetet institucioni i Presidentit, edhe në dritën e përgjegjësiive specifike direkte që ai ka për politikën e jashtme. Prandaj, mendoj se duhet durim dhe respekt për çdo minutë kohë që ky institucion kërkon për marrjen e një vendimi kaq kompleks dhe të rëndësishëm, siç është dekretimi i ministrit të Jashtëm", shprehet ish ministri Haxhinasto.

SHKURTE

Rama flet për "Shqipërinë e Madhe": Tezë provocative

Nënkryetari i LSI-së Luan Rama deklaroi dje se "Shqipëria e Madhe" është një sajesë antishqiptare dhe tezë provocative". Në një status në 'Facebook', ai shkruan se: "Shqipëria e Madhe" për të cilën janë shprehur me shqetësim ditëve të fundit edhe deputetë e ministra serbë, ka qenë e mbetet një sajesë antishqiptare dhe tezë provokative, e fabrikuar enkas për t'u përdorur si pretekst prej atyre që ëndërrjnë Serbinë e Madhe dhe që, ushqyer prej kësaj ëndrre, çuan në luftë e mbytjen në gjak ish-Jugosllavinë në fundshekullin XX". Më tej shton: "Nxitja dhe referimi në idenë e Shqipërisë së Madhe prej kujtudo që artikulohej apo prej kujtudo që përkratet, synon djallëzishit të implikojë shqiptarët e t'u faturtojë atyre kostot e konfliktit e të gjakderdhjes, për t'i paraqitur shqiptarët si provokatorë të konfliktit e destabilizimit në këtë pjesë të Europës.

Vasilii Tahiri mund të hante ndonjë grusht nga Rama

Kreu i Grupit Parlamentar i LSI, Petrit Vasili, në një postim në 'Facebook' komentoi dje përplasjen mes ish-zëvendëskryeministren e Kosovës, Edita Tahirit, dhe Edi Ramës në lidhje me mosdekretimin e Presidentit Ilir Meta për ministrin e ri të Jashtëm. Vasili shkruan se Tahiri ka shpëtuar mirë nga Rama, pasi vetëm e shau, se, nëse do ta kishte afër mund ta kishte rrahur. "Zj. Edita Tahiri 'shpëtoi' dhe ia hodhi vetëm me të shara nga Edi Rama. Se po të kishte qenë më afër do përfundonte shumë më keq, dhe mund të hante ndonjë grusht a shqel, a pëllëmbë, se e di gjithë dynjaja që ky i çmenduri Rama i rreh dhe i përdhunon gratë", shkruan Vasili.

on drejtpërdrejtë sigurinë kombëtare. Rama po qeveris në tejkalim të ligjit dhe Kushtetutës; fjala e tij është mbi ligjin për të vendosur çdo vartësi të tij në shërbim të qëllimeve që po nënkuptojnë. Institucionet më të rëndësishme si DSIK, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar që traj-

ton dhe informacionet për vetëqenë dhe gjyqtarëve dhe prokurorëve u provua në këtë rast se përdoret lehtësisht nga KM", tha z. Salianji. Sipas tij vendimi i Presidentit të Republikës është kushtetues derisa gjykata të shprehet, kushtetueshmërinë ose jo e vendos Gjykata Kushtetuese, jo KM!



"Po gabon shumë dhe mos shko ma tutje"

Baton Haxhiu, letër Ilir Metës: Refuzimi i Gent Cakajt, gabim historik

Pas vendimit të Presidentit të Shqipërisë, Ilir Meta për të mos dekretuar Gent Cakajn në postin e ministrit të Jashtëm, "Klan Kosova" publikon një letër të gazetarit Baton Haxhiu, njëkohësisht drejtuesi i këtij televizioni. Ai thekson në letër se është gabim historik mosdekretimi i Cakajt si ministër, megjithëse Presidenti Ilir Meta ka sqaruar me detaje vendimin e tij. Gent Cakaj është thënë gjerësisht në media se është propozuar nga Baton Haxhiu, i cili njihet për miqësinë e tij me Edi Ramën. Pas këtij refuzimi, Haxhiu deklaroi se e konsideron aktin e presidentit Meta "një veprim ta padenjë dhe antihistorik". "Sipas Kush-tetutës të Shqipërisë, rrjedhimisht, për dekretimin e ministrave të propozuar, roli yt, Ilir, është thjesht ceremonial. Në rast se do të shfrytëzosh zbrazëtitë në sistemin gjyqësor të Shqipërisë për llogari ditore politike dhe i ndikuar nga vala e paparë e thashethemeve të ditëve të fundit, Ilir, jo vetëm që nuk do të mundësoni emërimin në detyrë të një njeriu që përfaqëson shpresë në shoqëri dhe sjell dije në institucione, por në fakt, do të vulosni ndarjen e thellë institucionale midis Kosovës dhe Shqipërisë. Midis shqiptarëve të Kosovës dhe Shqipërisë", shprehet z.Haxhiu. Ai përmend se: "Duke bestuar se emri, të cilin mban mbi tryezë, për ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme paraqet cilësinë më të lartë për këtë detyrë dhe duke mbetur me shpresë se do të ngrihesh përmbi politikën ditore, interesat e ngushta dhe logjikën feudale ku është mbërthyer Shqipëria dhe Kosova, unë, miqësisht, të kërkoj dekretimin sa më të shpejtë të kryediplomatit më të merituar të Shqipërisë. Ilir! Dëgjoje mirë çka po të thotë Batoni: Po gabon shumë dhe mos shko ma tutjeshëm në këtë gabim historik!"



DEKLARATA

Z.Haxhiu deklaroi se e konsideron aktin e Presidentit Meta "një veprim ta padenjë dhe antihistorik". "Ilir! Dëgjoje mirë çka po të thotë Batoni: Po gabon shumë dhe mos shko ma tutjeshëm në këtë gabim historik!", shprehet z.Haxhiu.

Lëvizja "Vetëvendosje" në Kosovë përsëritet dje vendimin e presidentit Ilir Meta

Dekreti i presidentit, VV: Shqipërisë nuk i duhen ministra të Baton Haxhiut e Thaçit

Tahiri, Ramës: S'ishte i zoti të kundërshtojë ndryshimin e kufijve

"Për Cakajn, vendimi i Metës ishte kombëtar"

Isht kryenegociatorja e Kosovës për bisedimet me Serbinë, Edita Tahiri, iu përgjigj deklaratave të Edi Ramës kundër saj në lidhje me vendimin e Presidentit Ilir Meta për të mosdekretuar Gent Cakajn në postin e ministrit të Jashtëm. Gjatë intervistës për "Ora News", ajo theksoi se Rama nuk ishte i zoti për të kundërshtuar gjatë vizitës në Beograd ndryshimin e kufijve midis Kosovës dhe Serbisë. "Mendoj që Presidenti Meta bëri një vendim kombëtar dhe vizionar, sepse nuk dekretoi një kandidat që ishte hapur për ndryshimin e kufijve, që i bie që ka qenë hapur pro dëmtimit të interesave nacionale. Me këtë vendim, Presidenti Meta edhe një herë e rikonfirmoi ashtu siç është deklaruar, që është në mbrojtje të shtetit të Kosovës dhe luftës tonë 100-vjeçare për të ardhur deri tek pavarësia. Kryeministri Rama është mjaft i pasur me fjalorin e tij për të bërë reagime dhe si di si e gjen për kohën për këtë, në vend që të ulet dhe të mendojë strategjikisht për kombin shqiptar, për luftën gjeopolitike që po ndodh sot në dialogun e Brukselit. Vetë Edi Rama kur ishte në Serbi në vitin 2016 nuk ishte i zoti t'i thoshte 'jo' ndryshimit të kufijve homologut serb dhe në këtë lojë u përfshi edhe z.Thaçi, duke importuar ide serbo-ruse. Këtu nuk janë vetëm në dëm të Kosovës, por në dëm të kombit shqiptar. Sot është koha që vetë z.Rama të ulet dhe të mendojë pse nominoi këtë kandidat dhe pse largoi Dimitir Bushatin, i cili mbrojt kufijtë e Kosovës. Më shumë se çështje individuale, kjo është një çështje kombëtare", tha zj.Tahiri. Ajo përmendi se "liderët kanë përgjegjësi". "Unë jam një prej themeluesve të këtij shteti. Ne në 100 vjet kemi bërë luftë. Rama nuk ka qenë fare në Shqipëri për 10 vjet kur ne kemi luftuar përballë armikut. Kemi përjetuar gjithë atë gjenocid dhe prapë jemi ku jemi, sepse shqiptarët e bëjnë shqiptarinë dhe tokat janë tonat. Prandaj, këmbimi i territoreve nuk mund të ndodhë, sepse edhe veriu i Kosovës, edhe Lugina e Preshevs janë tonat. Të mos flasin që historia jonë ka qenë deri në Nish. Nuk e di se sa i di z.Rama këto se ndoshta është i zëmë me këto këmbime", deklaroi zj.Tahiri.

REAGIMI
Lëvizja "Vetëvendosje" në Kosovë përsëritet dje vendimin e presidentit Ilir Meta



EDITA TAHIRI

"Presidenti Meta bëri një vendim kombëtar dhe vizionar, sepse nuk dekretoi një kandidat që ishte hapur për ndryshimin e kufijve, që i bie që ka qenë hapur pro dëmtimit të interesave nacionale. Me këtë vendim, Meta e rikonfirmoi ashtu siç është deklaruar, që është në mbrojtje të shtetit të Kosovës dhe luftës tonë 100-vjeçare për të ardhur deri tek pavarësia".

"VETËVENDOSJA"

"Ne i vlerësojmë disa ide dhe politika progresive të qeverisë 'Rama', si kalimi nga taksa e sheshtë tek ajo progresive, vendosjen e shpërblyerit për fëmijët e sapolindur etj. Gjithashtu, e vlerësojmë edhe deklaratën e tij për pavarësinë e Kosovës në takimin e parë në Beograd me Vuçiqin, në datën 10 nëntor 2014, por emërimi i Gent Cakajt ka qenë krejt i pavend", thuhet në reagimin e "Vetëvendosjes".

për të mosdekretuar si ministër të Jashtëm Gent Cakajn. Përmes një deklaratë, "Vetëvendosja" thotë se Shqipërisë nuk i duhen ministrat të Baton Haxhiut e Hashim Thaçit. "Ne i vlerësojmë disa ide dhe politika progresive të qeverisë 'Rama', si kalimi nga taksa e sheshtë tek ajo progresive, vendosjen e shpërblyerit për fëmijët e sapolindur, etj. Gjithashtu,

e vlerësojmë edhe deklaratën e tij për pavarësinë e Kosovës në takimin e parë në Beograd me Vuçiqin në datën 10 nëntor 2014, por emërimi i Gent Cakajt ka qenë krejt i pavend", shprehet ndër të tjera "Vetëvendosja". VV sqaroi se: "Është për t'u mbështetur vendimi i drejtë i marrë sot nga Presidenti Ilir Meta për refuzimin e dekretimit të z. Gent

Cakajt si ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme i Republikës së Shqipërisë. Dëshirojmë ta sqarojmë opinionin e gjerë publik se Cakaj ka qenë i anëtarësuar formalisht në Lëvizjen "Vetëvendosje" para vitit 2011. Ne nuk e dimë datën e saktë të largimit të tij nga lëvizja, sepse ai nuk i ka dhënë asnjë shpjegim organizatës".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NJOFTIM PËR EKSPERTË DHE SPECIALISTË TË PAVARUR

Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe Vendimit të KPP-së nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", KPP shpall konkurrimin për plotësimin e listës vjetore të Ekspertëve dhe Specialistëve të Pavarur në fushat: Ekspert vlerësimi i pasurive të paluajtshme; ekspert kontabël i regjistruar; inxhinier elektronik/informatik; inxhinier mekanik; inxhinier hidrologjik; inxhinier elektrik; inxhinier gjeologji-minierash; inxhinier mjedisi; inxhinier ndërtimi; inxhinier tekstilë; kimist; specialist në farmaceutikë.

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat:

1. Të ketë mbaruar arsimin e lartë në fushën ku ai do të konkurrojë.
2. Të ketë licensë në fushat ku ligji parashikon pajisjen me të.

Pagesa dhe shpenzimet e ekspertëve apo specialistëve të pavarur do të bëhet me parapagim nga pala ankimese.

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 08 Shkurt 2019 në selinë e Komisionit të Prokurimit Publik këto dokumenta: kërkesën për aplikim, CV-në, fotokopje të diplomës dhe librezës së notave, fotokopje të licensës si ekspert, të librezës së punës, vërtetimin e gjenjës gjyqësore, fotokopje të kartës së identitetit, numër kontakti, si dhe adresën e plotë të vendbanimit

Njerëzit e vetingut do të marrin nga një pagë shpërblim për punën e kryer gjatë 2018-ës

Vendimi, qeveria shpërblen komisionerët e vetingut në drejtësi

Masa financiare e përfitimit, deri në 400 mijë lekë

Njerëzit që kanë marë rreth 400 mijë lekë në vitin e parë të drejtësisë nga të korruptuarit dhe të inkriminuarit janë vlerësuar financiarisht nga qeveria për punën e kryer prej tyre në vitin e parë të zbatimit të vetingut në Shqipëri. Në mbledhjen e fundit të Këshillit të Ministrave ka miratuar një vendim të veçantë, që u jep një pagë shpërblim të gjithë komisionerëve të vetingut, në dy nivele, si dhe gjithë administratës mbështetëse të tyre. Vendimi është publikuar në faqen zyrtare dhe përcakton në detaje masën e shpërblimit për secilin kategori. Kështu, përjashtimisht për vitin 2018, për institucionet e rivlerësimit jepet një shpërblim i ndarë në tri nivele, komisionerët, këshilltarët dhe administrata. Komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Komisionerët Publikë dhe gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit do të shpërblehen për punën e tyre të bërë gjatë 2018 në masën e një page mujore bruto, që përfshin pagën referuese bazë së bashku me shtesën për pagën në grup. Behet fjalë për një shpërblim që varion nga 400 mijë lekë të reja, që është paga bruto e kryetarit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në



372 mijë lekë, që është paga bruto e anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ndërkohë që sipas këtij vendimi, këshilltarët

ligjorë dhe ekonomikë, sipas përkatësisë të këtyre dy komisioneve shpërblehen në masën 80% të masës së shpërblimit që marrin komi-

SHPËRBLIMI

Komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Komisionerët Publikë dhe gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit do të shpërblehen për punën e tyre të bërë gjatë 2018 në masën e një page mujore bruto, që përfshin pagën referuese bazë së bashku me shtesën për pagën në grup.

shpërblehen përkatësisht në masën e vlerës së pagës për pozicionin dhe punonjësit e tjerë të administratës shpërblehen përkatësisht në masën e vlerës së pagës për klasë. Për efekt të këtij vendimi, përfitues të shpërblimit në masën e një page mujore bruto janë punonjësit që kanë punuar jo më pak se 12 muaj në institucion. Për punonjësit që kanë punuar jo më pak se 3 muaj në institucion, shpërblimi do të jetë i barabartë me gjysmën e pagës mujore bruto. Ndërkohë që efekti financiar i këtij vendimi përballohet nga fondi i veçantë i papërdorur nga ministritë dhe institucionet drejtore për vitin 2018. Në fakt, kjo nuk është hera e parë që qeveria shpërblen komisionerët e vetingut,

pasi një shpërblim, ndonëse në një masë më të vogël, e ka dhënë edhe në fillim të 2018 për vitin 2017. Në atë kohë atyre iu akordua një shpërblim në masën 100.000 (një-qind mijë) lekë, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 821, datë 30.12.2017, për një shtesë në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar. Pavarësisht vlerësimit që qeveria i ka bërë jo vetëm nëpërmjet një page të mirë, por edhe shpërblimeve dhe benefiteve të tjera, puna e komisionerëve të vetingut ka qenë objekt i kritikave të vazhdueshme të opozitës dhe një pjesë të mirë të opinionit publik. Shpeshherë opozita ka kritikuar vendimmarrjet e vetingut, si të ndikuara politikisht dhe të njëanshme. Gjithsesi deri më tani, këto dy komisione kanë marrë një sërë vendimesh të rëndësishme, duke nxjerrë jashtë sistemit të drejtësisë një numër të lartë gjyqtarësh dhe prokurorësh, si të papërshtatshëm për të dhënë drejtësi në vend. Rasti më i bujshëm ishte vendimi për të shkarkuar nga detyra kreun e Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

**SUPPLY OF STAFF UNIFORMS
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for the Supply of Staff Uniforms for Tirana International Airport for a period of two years with the possibility of renewal.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: kzoraqi@tirana-airport.com;
srada@tirana-airport.com; ialimema@tirana-airport.com; apalushi@tirana-airport.com specifying, request for information for "Supply of staff uniforms".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail.

This tender will be organized in two phases:

- In the first phase companies will need to present similar works through uniform samples performed for other companies, letter of references and also a sample of the proposed materials.
- In the second phase short listed companies will need to submit their financial offer together with the sample for Tirana International Airport.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'Supply of Staff Uniforms for Tirana International Airport'.

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Procurement Department
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of samples at the above address is **16:00 hrs. on 25 January 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all following addresses:
kzoraqi@tirana-airport.com
srada@tirana-airport.com
ialimema@tirana-airport.com
apalushi@tirana-airport.com

INVITATION FOR BIDS (IFB)

Date: 09.01.2019
Contract Identification N°: Ref: AL-8521/CW/NCB/2.1.03
World Bank Loan/Credit N°: 8521-AL
World Bank Loan/Credit Name: *Citizen Centric Service Delivery Project*

- This Invitation for Bids follows the General Procurement Notice for this Project that appeared in *Client Connection online*, on August 28, 2015.
- The *Government of Albania* has received a loan from the International Bank for Reconstruction and Development towards the cost of *Citizen Centric Service Delivery Project* and intends to apply part of the funds to cover eligible payments under the Contract for **"Refurbishing and furniture of the Integrated Citizen Service Center of Kombinat"**. Ref: AL-8521/CW/NCB/2.01.03. Bidding is open to all bidders from eligible source countries as defined in the *Guidelines: Procurement under IBRD Loans and IDA Credits*².
- The Agency for Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA) invites sealed bids from eligible bidders for Refurbishing and furniture of the Integrated Citizen Service Center of Kombinat. The main objective is the fulfillment of all required spaces, while achieving functional performance, fulfilling according norms and standards, finishing treatment, and required humidity, flow of light, ventilation and air-conditioning. The detailed project consists in the refurbishment/ reconstruction of the selected premise and its adaptation into a center for the provision of public services through the establishment and management of receiving counters for the citizens (front office) and integrated public service centers (one stop shop).
- A complete set of Bidding Documents in English may be obtained at no cost by interested bidders on the submission of a written application or e-mail to the address given below. Further the Bidding Documents may also be downloaded from any of the following websites: www.adisa.gov.al
Project Management Unit
Blvd: Zhan d'Ark,
Ish shtëpia e oficerave, Kati V-te
Tirana, Albania
e-mail: roland.larashi@adisa.gov.al;
info@adisa.gov.al
and fiorentina.jorgji@adisa.gov.al
- Bids shall be valid for a period of 60 days after Bid closing and must be accompanied by security of 5,000 EUR or an equivalent amount and shall be delivered **Project Management Unit**
Blvd: Zhan d'Ark,
Ish shtëpia e oficerave,
Kati V-te, Tirana, Albania
Tel: +355666191381

on or before **06 February 2019, at 12.00**, local time at which time they will be opened in the presence of the bidders who wish to attend.

Ortekë në Tropojë, bllokohen akset rrugore. Pezullohet mësimi në disa shkolla

Moti i keq "paralizon" gjithë vendin, izolohen mijëra banorë në zonat e thella

Shembet çatia e një karburanti nga peshja e borës, humb jetën punonjësi 53-vjeçar në Shkodër

Reshjet e dëborës dhe ngricat kanë "paralizuar" gjithë vendin. Që prej disa ditësh, mijëra banorë në zonat e thella janë izoluar nga veriu në jug. Burime zyrtare bëjnë me dije se situata paraqitet më problematike në qarqet: Dibër, Kukës, Shkodër, Korçë dhe Gjirokastrë. Krahas problemeve në qarkullimin e mjeteve, shqetësime të tjera ka patur edhe në furnizimin me energji elektrike. Si pasojë e motit të keq, në qarkun e Dibrës, Korçës, Pukës dhe Fushë-Arrëzit është pezulluar mësimi. Edhe në Qarkun e Gjirokastrës në pjesën më të madhe të shkollave dhe nuk është zhvilluar mësim. Në qarkun Kukës me përjashtim të pak shkollave në qytet, në të gjitha institucionet e tjera arsimore nuk është zhvilluar proces mësimor. Burime nga Ministria e Arsimit dhe bënë me dije se për shkak të motit të keq, në 16 drejtori dhe Zyra Arsimore mësimi është pezulluar totalisht, në 6 drejtori vetëm disa shkolla janë mbyllur, ndërsa mësimi po zhvillohet me orë të shkurtuar në të gjithë vendin. Ndërkaq, një 53-vjeçar në Shkodër ka humbur jetën, pasi streha e një karburanti është shembur për shkak të shkak të rëndësës së dëborës. Bëhet fjalë për Tonin Locin, punonjës tek karburanti, i cili ndodhej në hyrje të qytetit verior. Pas shembjes ka patur dhe shpërthim zjarri dhe ka qenë e pamundur për punonjësin dalja nga ndërtesa e shembur. Në vendngjarje kanë mbërritur forcat zjarrfikëse dhe policia vendore. Gjithashtu, në vendin e quajtur "Kryqëzimi i fermentimit" është shembur një tjetër karburant, por fatmirësisht nuk ka të lënduar. Pas aksidentit ka reaguar Ministria e Mbrojtjes, e cila iu ka bërë thirrje të gjithë subjekteve dhe banorëve në zonat e prekura nga dëbora që të marrin masa për pastrimin e çatave. "Të merren masa të menjëhershme për pastrimin e tyre me qëllim parandalimin e ngjarjeve të tilla tragjike," shkruhet në njoftimin e ministrisë së Mbrojtjes.

SITUATA NËPËR QARQET

Mbi 50 centimetra ka arritur trashësia e dëborës në qytetin e Peshkopisë, ndërsa në zonat e thella tashmë ka kaluar një metër, duke izoluar kështu thuasjë të gjithë fshatrat. Kjo situatë ka bërë që qarku i Dibrës të ngrejë Shtabin e Emergjencave. Veç rrugëve rurale që janë të gjitha të bllokuara, situata paraqitet problematike edhe në rrugën nacionale Peshkopi-Tiranë e cila është e bllokuar në 2 segmente në Qafën e Ulzës dhe në Bulqizë, nga pishat deri në Qafë të Buallit. Peshkopi - Kala e Dodës Kukës kalohet vetëm me automjete të kalueshmërisë së lartë me zinxhirë



Rrugët e bllokuara nga dëbora



BULQIZË

Nga Ostreni i Bulqizës, vjen një apel për ndihmë nga banorët e izoluar nga bora, e cila arrin mbi 1 m. Përveçse pa mungesë energjie elektrike dhe të bllokuar në rrugët e mbuluara nga dëbora, këta banorë nuk mund të lëvizin as për probleme shëndetësore. "Jemi pa energji elektrike. Rrugët janë të bllokuara. Nuk mund të lëvizim as për probleme shëndetësore", - u shpreh dje një nga banorët e Ostrenit.

deri në Sllovë, më tej e bllokuar. Trashësia e borës kalon mbi 1 metër dhe është e pamundur sapo kalon borë pastruesja bllokohet për 10 minuta. Gjatë natës, në aksin Peshkopi-Tiranë ka qenë edhe prefekti i Dibrës. Në këtë aks nuk kanë mundur as aksidentet. Problemi ka edhe në aksin Bajram Curri-Valbonë ku ka rënë ortekësh në 2 vende duke bllokuar qarkullimin, dhe po punohet për hapjen e rrugës. I njëjti fenomen ka ndodhur edhe në Qafën e Malit-Pierzë në vendin e quajtur "Arstë" dhe "Porav". Në Shkodër, borëpastrueset po mbajnë hapur rrugët nacionale në territorin e qarkut të Shkodrës. Një borëpastruese po punon gjatë gjithë kohës në aksin Shkodër-Hani i Hotit, reshjet e dëborës janë intensive. Ndërsa vështirësitë më të mëdha janë në rrugët rurale dhe lidhja e tyre me rrugët kryesore. Rrugët lidhëse janë thuasjë të pakalueshme. Banorët detyrohen të ecin në këmbë. Reshjet e dëborës në gjithë qarkun e Shkodrës kanë vijuar për 24 orë

duke krijuar probleme të mëdha në shumë zona. Gjithashtu, reshjet e dëborës kanë paralizuar qarkullimin në gjithë fshatrat e Pukës, ndërsa kanë shkaktuar vështirësi qarkullimi edhe në akset nacionale.

Reshjet e dëborës janë shoqëruar, gjithashtu, me problematika në qarkun e Kukësit, ndërsa shumë vende të thella malore janë të bllokuara dhe trashësia e dëborës arrin mbi 50 centimetër. Kjo gjithashtu është shoqëruar edhe me mungesë të furnizimit me energji elektrike.

Në Mirditë pjesa më e madhe e fshatrave janë të

bllokuara. Rruga e Kombit është e kalueshme me vështirësi pasi reshjet e dëborës janë rikthyer. Ky segment është bllokuar herë pas here për shkak të dëborës në rrugë që solli edhe rrëshqitjen e mjeteve të tonazhit të lartë.

Në Lezhë situata është përmirësuar pas rikthimit të reshjeve të shiut, ndërsa problem mbetet lëvizja drejt zonës së Ungrejtit, pasi në zonën e quajtur Kreshhtë dëbora ka krijuar vështirësi në qarkullim.

Në jug, situata më problematike paraqitet në qarkun e Gjirokastrës, ku të gjitha fshatrat janë izoluar nga dëbora. Kalimi është i mundur vetëm në rrugët nacionale. Në juglindje bora kalon gjysmë metër. Të gjitha zonat malore në Korçë janë të izoluar. Aksi Korçë-Qafë Thanë-Kapshiticë është i kalueshëm normalisht, ndërsa në rrugët e tjera nacionale lëvizet vetëm me zinxhirë. Problematik dhe i rrezikshëm mbetet qarkullimi në rrugën Korçë-Ersekë, në Qafën e Qarrit, ku ka mbi 40 centimetër borë.

SHKURTE

Reshjet e dëborës, 115 familje në Tërnovë të Dibrës, të izoluar

Të gjitha njësitë administrative të Qarkut Dibër, janë të izoluar, por më problem mbeten Lura, Kala e Dodës, Selishta, Ostreni, Trebishti, Arras, Martaneshi, Xibri e Macukulli në Mat. Shtabet e emergjencave civile janë mbledhur në katër bashkitë e qarkut Dibër, të cilët kanë kërkuar ndërhyrje emergjente. Mësohet se tashmë bashkitë e qarkut kanë nisur punën për hapjen e rrugëve kryesore të njësjve administrative, por mjetet e kanë të pamundur të zhbllokojnë situatën pasi reshjet vazhdojnë me intensitet të lartë. Gjithashtu, është raportuar se në shumë fshatra ka pasur mungesë të energjisë elektrike si pasojë e këputjes së telave. Problem mbeten edhe 115 familjet e fshatit Tërnovë në Bulqizë ku prej 10 ditësh janë të izoluar pasi dëbora shkon në 1 metër e 50 centimetra.

Gjirokastrë, banesa rrezikon shembjen, 1 fëmijë i sëmurë

Moti i keq dhe reshjet e dëborës kanë shkakuar shumë probleme në Gjirokastrë. Kështu, në lagjen "Palorto", në zonën muzeale, një banesë rrezikon shembjen. Mësohet se banorët kanë kërkuar ndihmën e forcave zjarrfikëse për ndërhyrje në pastrimin e çatisë. Ndërkohë, nevojë për përkujdesje ka pasur edhe një i moshuar, i cili është ndihmuar nga forcat zjarrfikëse për të shkuar në spital, pasi rruga në lagjen muzeale "Palorto" është ende e bllokuar nga bora. Po ashtu, forcat zjarrfikëse janë nisur drejt fshatit Kolonjë, të njësisë administrative Pëcar, pasi një fëmijë i mitur është me temperaturë të lartë dhe autoambulanca e ka të pamundur të shkojë.

Pukë/ Dëbora arrin në dy metra, prefekti: Jemi të izoluar



Prefekti i Pukës, Gjon Dodaj, tha për "Gazeta Shqiptare" se trashësia e dëborës në disa vende arrin në 2 metra. Ai theksoi se të hapura janë të gjitha akset nacionale, por zonat e thella janë tërësisht të izoluar. Gjithashtu, ai u shpreh se ka pasur një rast lindjeje, i cili sipas tij ka kaluar fatmirësisht pa asnjë problem. "Ka

ditë që në Pukë bien reshje dëbore të dendura, e vila kalon në 70 centimetra. Trashësia e dëborës për shkak të erërave shkon edhe në 4 metra. Rrugët rurale janë të bllokuara. Ky kërkuar ndihmë nga shtabi i emergjencave, presin të vijë një borëpastruese. I gjithë rrethi nuk ka probleme me furnizimi me energji elektrike", -pohoi ai.

PROTESTA E STUDENTËVE REAGIMET

Pedagogët i bashkohen diskutimit. Shtyrje mësimit deri në plotësimin e kërkesave

Studentët ngujohen brenda fakulteteve: Nuk tërhiqemi, nuk dorëzohemi

"Qeveria po na bën presion me forcat policore, s'kemi frikë"

Voltiza Duro

Prej dy ditësh, studentët e disa prej universiteteve publike në vend, kanë zgjedhur të zhvendosin protestën e tyre nga rruga nëpër fakultete. Ata kanë bojkotuar sërish mësimin e sallat e leksioneve tashmë po i përdorin për të diskutuar për problematikat e universiteteve dhe zgjidhjet që mund të jepen për përmirësimin e situatës, së bashku me pedagogët. Studentët deri më tani shohin rrëzimin e ligjit të arsimit të lartë si të vetmen mënyrë për t'i dhënë fund kolapsit të krijuar në institucionet e arsimit të lartë në vend. "Ne nuk do të tërhiqemi deri në plotësimin e të gjitha kërkesave tona. Do të rrimë këtu, do të diskutojmë me njëri-tjetrin për t'i dhënë një zgjidhje ngërcit universitar, por kurrsesi nuk do të kthehemi në leksione", tregon një prej studentëve për 'GSH'. Ndërkohë një tjetër student liston edhe njëherë të gjitha kërkesat. Ne kërkojmë: përgjysmimin e tarifave në TË GJITHA nivelet e studimit (sidomos në master); rritjen në 50% të peshës së VOTËS STUDENTORE; dyfishimin e BUXHETIT TË SHËTËTIT për universitetet publike; ndalimin e financimit publik të UNIVERSITETEVE PRIVATE. Asnjë kërkesë nuk mund të realizohet pa rrëzimin e Ligjit të Arsimit të Lartë. Këto janë kërkesat tona. Pa plotësimin e tyre ne nuk do të kthehemi në auditore", thekson një prej studenteve të Fakultetit të Histori-Filologjisë për GSH.

NGUJIMI NË FAKULTETE

Mbi 100 studentët të Fakultetit të Drejtësisë, kanë zgjedhur të ngujohen ditën e djeshme brenda ambienteve të fakultetit dhe janë shprehur që vendimet do të merren bashkërisht mbi vijimin e protestës së tyre. "Nuk mund të them sesi do të vazhdojë përshkallëzimi i qëndrësës sonë pasi vendimet do t'i marrim të gjithë studentët



Studentet dje në fakultete



FORMA E PROTESTËS

"Në Fakultetin e Shkencave Sociale jo vetëm që vazhdon bojkoti, por universitarët përmes zaptimit kanë vendosur ta banojnë universitetin me aktivitete të ndryshme: diskutime e kritikë për ligjin klientelist për arsimin e lartë, lexim librash, shfaqje filmash/dokumentarësh rezistence, etj. Universitetin e bëjmë vetë! Studentët e bashkuar kanë për të fituar!", -thotë një prej studenteve të këtij fakulteti.

së bashku. Siç e kemi deklaruar edhe më parë, ne nuk kemi përfaqësues, secili prej nesh përfaqëson vetveten. Ashtu si dhe më parë, nuk do të pranohet asnjë eksponent të partive politike. I kemi tmer: Protesta jonë është e depolitizuar. Por diçka e dimë me siguri, do të qëndrojmë këtu, të palëvizur, pavarësisht penalizimeve që mund të kemi nga stafi akademik (me mungesa) dhe policia. Mësimi do të shtyhet deri në plotësimin e kërkesave tona, e deri në rrëzimin e ligjit të

arsimit të lartë", -thotë studentit të Drejtësisë për 'Gazeta Shqiptare'. Edhe një pjesë e studentëve të Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tiranës, kanë bojkotuar mësimin dhe kanë diskutuar mbi format e protestës së tyre. ndërkohë një pjesë tjetër e studentëve në këtë fakultet i janë rikthyer leksioneve, ku shumë prej tyre po ndjekin udhëzimin e Ministrisë së Arsimit për plotësimin e dokumentacionit me qëllim përfitimim e bursave dhe uljes së tarifave. Edhe në

PRESIONI

"Edhe ditën e sotme qeveria ka urdhëruar, duke shkelur ligjin, forca policie që të qëndrojnë pranë ambienteve universitare në formë presioni. Studentët jo vetëm nuk frikësohen, por janë siguruar që mos të shkelet ligji duke i përzënë policët jashtë universitetit. As trembemi, as tërhiqemi!", -thotë një tjetër student për 'GSH'.

Fakultetin e Shkencave Sociale në UT, mësimi është bojkotuar sërish. "Në Fakultetin e Shkencave Sociale jo vetëm që vazhdon bojkoti, por universitarët përmes zaptimit kanë vendosur ta banojnë universitetin me aktivitete të ndryshme: diskutime e kritikë për ligjin klientelist për arsimin e lartë, lexim librash, shfaqje filmash/dokumentarësh rezistence, etj.

Universitetin e bëjmë vetë! Studentët e bashkuar kanë për të fituar!", -thotë një prej studenteve të këtij fakulteti.

PËRPLASJA ME ROJET

Ditën e djeshme, në Fakultetin e Drejtësisë në UT ka pasur përplasje mes studentëve dhe rojeve të sigurisë private. Fillimisht të rinjtë kanë tentuar të hyjnë brenda fakultetit nga dritarja, por hasën në pengesën e rojës. Më tej mes tyre situata ka qenë e tensionuar dhe plot debate. "Mos më prek. E di vet unë nga ka futem", shprehet një nga studentët që ndalohej nga roja. Ndërkohë forca policie kanë qëndruar pranë ambienteve të fakulteteve, çka për studentët konsiderohet si presion nga qeveria. "Edhe ditën e sotme qeveria ka urdhëruar, duke shkelur ligjin, forca policie që të qëndrojnë pranë ambienteve universitare në formë presioni. Studentët jo vetëm nuk frikësohen, por janë siguruar që mos të shkelet ligji duke i përzënë policët jashtë universitetit. As trembemi, as tërhiqemi! Universiteti i universitarëve, jo i pushtetarëve!", -thotë një tjetër student për 'GSH'.



Studentet duke protestuar

KËRKESAT E STUDENTËVE

- Përgjysmimin e tarifave në TË GJITHA nivelet e studimit (sidomos në master);
- Dyfishimin e BUXHETIT TË SHËTËTIT për universitetet publike;
- Ndalimin e financimit publik të UNIVERSITETEVE PRIVATE.
- Të zbatohen ligjet për individët: "Për statusin e të verbrit", "Për statusin e jetimit", "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" etj. Të cilët duhet të kenë lehtësira për pagesën e tarifës vjetore.
- Të pyeten dhe të konsultohet me student të cilët kanë këtë status për çdo moszbatim të ligjit dhe ndryshime të tij.
- Të merren në konsideratë çdo sugjerim i studentëve me statusin, "Për statusin e të verbrit", "Për statusin e jetimit", "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" etj.
- Asnjë kërkesë nuk mund të realizohet pa rrëzimin e Ligjit të Arsimit të Lartë.
- Rishikimi i titujve akademikë dhe verifikimi i teksteve mësimore.
- Mbështetur në nenin 99 mbi Këshillat Studentore, ligji i arsimit të lartë, pika 2 kërkojmë që bordi i administrimit të IAL-ëve të ketë numër të barabart votash si nga MAS dhe IAL-t si edhe të shtohet një përfaqësues në këtë bord nga studentët.
- Pajisja e të gjithë studentëve me kartën e studentit brenda vitit akademik 2018 - 2019.
- Ndërtimi i bibliotekave me standarde europiane dhe me libër universitar online, falas për studentët në gjuhën shqipe.
- Vlerësimi i performancës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor i pedagogut, publikimi i tij online dhe regjistrimi i leksioneve.
- Rritja e buxhetit të arsimit në 5% të GDP, me qëllim mundësimin e përgjysmimit të tarifës së studimit për çdo nivel studimi, përmirësimin e infrastrukturës dhe mësimdhënies (universitete dhe konvikte).
- Transparencë me buxhetin nga Ministria e Arsimit dhe IAL-ve, publikimi të gjitha shpenzimeve online.
- Rritja nga 10% në 50% e peshës totale të votës së studentëve për të zgjedhur kandidatët për dekanë, rektorë dhe çdo fakultet të ketë një përfaqësues të studentëve në senatin akademik.

Shitje me Ankand te Pare nga Studio Permbartore L.D.C

"Trulli + ndertese" me nr. pasurie 286/5/1, vol.3, faqe 36, Zona Kadastrale. 3866, me sipërfaqe totale 300 m2, regjistruar ne Z.V.R.P.P. Tirane. Cmimi fillestar per shitje eshte 3.107.280 Leka. Data e shpalljes 20.12.2018. Data e zhvillimit 15.01.2018 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbartore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.



Afera, kreu i PD: Faktet e publikuara nga "Zëri i Amerikës" janë tronditëse

Unaza, Basha: Qëndresa e banorëve, gjysma e qeverisë u hodh në Lanë

"Vegla tinëzare e Ramës s'përçau dot protestën"


Valentina Madani

Kreu i PD, Lulzim Basha, shprehu dje sërisht mbështetje për banorët e Unazës së Madhe, që janë kundër projektit që ata e quajnë korruptiv. Z.Basha në krah të banorëve të "Astirit" përmendi se qëndresa e banorëve përbys gjysmën e qeverisë, ndërsa gjysmën tjetër do ta përbysë shumë shpejt. Sipas tij, Rama nuk ia arriti të përçajë protestën, por ishin qytetarët ata që dolën fitimtarë duke përçarë qeverinë, që çoi në zëvendësimin e ministrave. Basha vuri në dukje se denoncimet e opozitës u faktuan në lidhje me kompaninë fantazmë, që kishte marrë tenderin për planin për të zhvendosur Lanën. "Asgjë nuk është më e fuqishme sesa një kauzë e vërtetë, e mbështetur nga njerëz të bashkuar. Merita e madhe e këtyre banorëve është se vegla më tinëzare e Edi Ramës, përçarja përmes kërcënimeve, shantazheve e propagandës nuk p'u ujë. Nuk ia dolën t'i përçajnë këta banorë. Këta banorë me qëndresën e tyre e çanë në gjysmë qeverinë. Një gjysmë ia kanë hedhur në Lanë dhe gjysmën tjetër do t'ia hedhin në Lanë shumë shpejt", deklaroi Z.Basha. Kreu i PD-së garantoj se banorët do të qëndrojnë deri në fund dhe do të fitojnë. "Protestuesit e Unazës së Re kanë dhënë një shembull për të gjithë, shembulli është para syve tuaj. Kur mbron një kauzë të drejtë, kur kërkoni që fajtorët të shkojnë para ligjit, nuk rrëzohet qytetari dhe jam i bindur se kjo do të rrezojë klikën e korruptuar dhe këta banorë do të fitojnë", - u shpreh Z.Basha. Kreu i PD-së shtoi më tej se faktet që ka zbuluar nga "Zëri i Amerikës" se shteti ka qenë pjesë e falsifikimit të këtij projekti janë tronditëse.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha dje me banorët e Unazës së Re

SALI BERISHA
Ish-kryeministri Sal Berisha dënoi dje praninë e ish-ministrit Gjoknuri dhe ministres se re, Balluku, në takimin me studente të Politeknikut. Ai shkruan se prania e tyre në takim është një presion i hapur ndaj të rinjve dhe përdhosje e autonomisë universitare dhe u bën thirrje studentëve të mos pranojnë më ministra në takimet e tyre. Kryeministri u kërkoi ndjesë studentëve e prindërve



Protesta, Rama: Kjo maskaradë s'do devijojë dot rrugën e nisur

Kryeministri Edi Rama reagoi dje me një mesazh ndjese për të gjithë ata studentët dhe prindër të tyre, që sipas tij, i shkruajnë me shqetësim për bllokimin e mësimin në auditorë. Me një shënim në logarinë e tij në rrjetin social "Twitter", Rama e cilëson gjithë sa po ndodh, "dorë të politikës që fshihet pas këtij agresioni të papranueshëm ndaj universitetit". Sipas Ramës, "kjo maskaradë s'do ta devijojë dot rrugën e nisur me studentët". "U kërkoi ndjesë e mirëkuptim studentëve e prindërve, që përmes mijëra mesazhesh ankohen për pengimin e dhunshëm të mësimin. Përbuzje për politikën që fshihet pas këtij agresioni të papranueshëm ndaj universitetit. Kjo maskaradë s'do ta devijojë dot rrugën e nisur me studentët. Universitetet kanë dorëzuar në Ministrinë e Arsimit të gjitha listat e studentëve që do të përfitojnë mbështetjen tonë financiare, sipas Vendimit të Qeverisë. Ministria e Financave ka nisur sot (dje) punën për të realizuar alokimin e fondeve në çdo universitet, student për student. Nesër (sot) është gati për prezantim publik portali i Programit të ri Kombëtar të Punësimit në administratë të studentëve më të mirë. Ky program është një nga risitë e reflektimit mbi protestën, i cili na çoi shumë përtej 8 kërkesave# QentëLe Të Lehin ne do shkojmë së bashku përpara", shprehet Z.Rama.

PD paralajmëron policinë: Qëndroni larg universiteteve!

Partia Demokratike akuzon kryeministrin Edi Rama se po përdor politikisht policinë për të kërcënuar, shantazhuar dhe ushtruar presion ndaj studentëve. Deputetja Albana Vokshi deklaroi se, "narkopolicia nuk duhet të guxojë të prekë studentët paqësorë dhe as të dhunojë mjediset universitare". Vokshi përmendi se ligji e ndalon rreptësisht hyrjen e policisë në fakultete. PD paralajmëron kryeministrin dhe veglat e tij në polici se do të paguajnë për kërcënimet e tyre për arrestimin apo ndjekjen penale të studentëve. "PD dënon me ashpërsi këtë akt të paprecedentë në Shqipëri dhe paralajmëron të gjithë ata që urdhërojnë presionin policor ndaj studentëve se herët apo vonë do të përgjigjen para ligjit.



Narkopolicia nuk duhet të guxojë të prekë studentët paqësorë dhe as të dhunojë mjediset universitare. Ligji për Arsimin e Lartë e ndalon rreptësisht hyrjen e policisë në fakultete, përveçse kur prania e tyre kërkohet nga drejtuesit në rastet e krimeve flagrante. Ligji siguron 'ndëshkimin për cenimin e paprekshmërisë së institucioneve të arsimit të lartë'. Deri tani, organet e drejtësisë nuk kanë ndërmarrë asnjë ve-

rim për të ndëshkuar shkeljen e hapur të paprekshmërisë territoriale të universiteteve nga narkopolicia politike e Edi Ramës. Gjithashtu, PD dënon deklaratën kërcënuese të policisë, të shkruar nga Edi Rama dhe paralajmëron kryeministrin dhe veglat e tij në polici se do të paguajnë për kërcënimet e tyre për arrestimin apo ndjekjen penale të studentëve", - shprehet zj.Vokshi.

uar se jo vetëm nuk ka bërë detyrën, por ka qenë pjesë e falsifikimit", deklaroi kreu i opozitës. Sipas kreut të PD, denoncimet e opozitës u faktuan në lidhje me kompaninë fantazmë që kishte marrë tenderin për planin për të zhvendosur Lanën. "Një media e rëndësishme amerikane publikoi

dje faktin që ne e kemi përsëritur. Të gjithë e dinë se si nisi kjo aferë. U turën pa marrë leje për të prishur shtëpitë, pa çarë kokën për banorët. Banorëve u vërsulën Policinë e Shtetit dhe atë bashkiake. Nga Rama te Veliaj e Gjoknuri hidhnin vallen e hienave duke shantazhuar

banorët". Qëndresa e banorëve, bashkë me opozitën dhe disa gazetarë nxorën aferën korruptive të një kompanie fantazmë, të një plani për të zhvendosur Lanën dhe për të shkatërruar shtëpitë e banorëve që të mos prekej rezidenca e një trafikanti droge", tha Basha.

Njoftim për shitje me ankand

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e parë të pasurisë të palles debitorë Shoqëria "ARNI" sh.p.k. Pasuria që delane ankand të pare përbehet nga: "Apartament" me Nr pasurie 69/11/ND +1-14 ndodhur ne Rr "Dodona", Hyrja nr.1, Kati 3 AP 14, Oriktum e regjistruar ne ZVRRP- Vlore, Z K Nr.2832, volumi 16, faqe 120, me sipër 43 m2

Ankandi i pasurisë fillon me cminin fillestar në masën 1.920.000 lekë
Ankandi do të zhvillohet në datë 25.01.2019 në orën 15:00 në selisë "Bul "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5. Kontakt: 0672082543 ilir_dervishaj@yahoo.com faqen WEB www.powerjustice-al.com

Erjon Bengaj: Me autorin u zumë me grushte. Tropojani: Jam çun e mund të ngacmoj çdo vajzë


TIRANË

Dy javë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në zonën e Laprakës, ku mbeti e vrarë 17-vjeçarja Griselda Gjokolaj dhe u plagosur Erjon Bengaj, "Gazeta Shqiptare" ka siguruar dosjen e plotë të prokurorisë në lidhje me krimin që tronditi kryeqytetin. Në këtë dosje jepet dinamika e plotë e ngjarjes që nga përndjekja e vajzës me origjinë nga Kurbneshi i Mirditës nga 19-vjeçari Robert Perpepaj, shërr me Erjon Bengën, mik me të fejuarin e viktimës e deri te përgatitja e atentatit nga autori dhe bashkëpunëtori i tij, Ronald Muzhaqi. Atentat ky i ndodhur mbrëmjen e 26 dhjetorit të vitit që shkoi në vendin e quajtur "Pallatet Gintash" në Laprakë. Referuar dokumentit zyrtar, rezultoi se e mitura është qëlluar me dy plumba në kokë nga i dyshuari Robert Perpepaj, i cili prej disa kohësh e përndiqte sistematikisht dhe ishte kthyer në shqetësim për të. Vajza - thuhet në dosje se i ka rrefyer të fejuarit të saj Samir Hoxha, shqetësimet që po i sillte Roberti duke i kërkuar ta mbronte prej tij. Referuar dosjes, rezultoi se 10 ditë përpara ngjarjes, i fejuari i 17-vjeçares dhe shoku i tij Erjon Benga janë konfliktuar me grushte pranë fushës së Laprakës në Tiranë me të shumëllojshme 19-vjeçar Benga i ka kërkuar atij që të mos e ngacmonte Griseldën, por Perpepaj i është përgjigj se "jam çun e mund të ngacmoj çdo vajzë". Në debat e sipër, Erjon Benga e ka qëlluar me shpulle të riun me origjinë nga Tropoja. Prej atij momenti, Roberti nuk është bërë i gjallë, deri mbrëmjen e 26 dhjetorit kur edhe ndodhi krimi i rëndë. Dyshimet janë se gjatë ditëve të fundit, ai ka planifikuar të hakmerret jo vetëm ndaj Erjon Bengas, por edhe t'i marrë jetën vajzës, që përndiqte në çdo moment. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, pamjeve filmike të siguruara nga kamerat e sigurisë në bizneset afër vendit ku ndodhi vrasja si dhe bazuar në dëshminë e dhënë nga Benga, në dosjen e prokurorisë jepet me detaje se si ndodhi ngjarja.

DËSHMIA E ERJON BENGËS
I pyetur në cilësinë e personit që ka dënuar për hetimi, Erjon Benga ka deklaruar se ditën e ngjarjes, rreth orës 16:00, ka marrë në telefon shokun e tij Sajmir Hoxha, i cili i ka thënë se është në qendër të lodrat. Sipas deklaruësit, me automjetin e tij tip "Benz Mercedes" me ngjyrë të zezë dhe me targa AA 266 MS ka shkuar në qendër, ka parkuar mjetin dhe më pas është takuar me Saimirin, i cili ishte në shoqërinë e 3-4 gocave. Pasi janë përshëndetur me vajzat, njëri prej të cilave e ka çuar në parku-

Përndjekja, ja si u ekzekutua me dy plumba në kokë 17-vjeçarja Griselda Gjokolaj

Pak ditë para ngjarjes, viktima i tha të fejuarit se e ngacmonte 19-vjeçari Robert Perpepaj



17-vjeçarja e vrarë, Griselda Gjokolaj



Vendi ku ndodhi ngjarja

VRASJA

Katër të rinjtë kanë dalë nga lokali dhe kanë hipur në makinë, ku në vendin e drejtuesit ka hipur Erjoni, ndërsa Saimiri në vend të parë. E ndjera Griselda prapa tij dhe Romina prapa Saimirit. Sapo kanë ecur rreth 20 metra, përpara tyre kanë dalë dy djem të rij, të cilët kanë gjuajtur me leva dhe në këtë çast i kanë dhënë shpejtësi mjetit. Sipas Erion Bengës, në këtë moment ka parë që personi që ishte në krah të tij, i quajtur Robert Perpepaj ka gjuajtur me pistoletë në drejtim të tij, ndërsa personi tjetër ka gjuajtur me levë në drejtim të vendit ku ishte ulur Saimiri.

qan, janë kthyer më pas në Larakë të lokal "Oblika", ku kanë parkuar makinën në parking dhe më pas janë ulur në lokal. Sipas Bengës, brenda në lokal i prisnin dy shoqet e tyre, e ndjera Griselda Gjokolaj dhe Romina Levanaku. Pasi janë ulur dhe kanë pirë diçka, kanë rënë dakord që të shkonin te puna e Saimirit në Tapizë. Kanë dalë të katërt dhe kanë hipur në makinë, ku në vendin e drejtuesit ka hipur Erjoni, ndërsa Saimiri në vend të parë. E ndjera Griselda prapa tij dhe Romina prapa Saimirit. Sapo kanë ecur rreth 20 metra, përpara tyre kanë dalë dy djem të rij, të cilët kanë gjuajtur me leva dhe në këtë çast i kanë dhënë shpejtësi mjetit. Sipas Erion Bengës, në këtë moment ka parë që personi që ishte në krah të tij, i quajtur Robert Perpepaj ka gjuajtur me pistoletë në drejtim të tij, ndërsa personi tjetër ka gjuajtur me levë në drejtim të vendit ku ishte ulur Saimiri. Në kushtet e mësipërme, Benga e ka shtuar shpejtësinë dhe pasi ka

ndjerë që ishte plagosur është drejtuar me shpejtësi në drejtim të Spitalit të Traumës. Por ende pa mbërritur në duart e mjekëve, Griselda kishte ndërruar jetë. Ndërkohë, që Benga është në gjendje të stabilizuar shëndetësore. Për fat të mirë, ai dhe mikësja e ngushtë e vajzës nuk u prekën nga plumbat. Skena e krimit që tronditi kryeqytetin funddhjetorin e vitit që sapo lamë pas u rindërtua nga hetuesit, bazuar në rrëfimet e të mbijetuarve të atentatit dhe pamjeve filmike të kamerave të sigurisë së bizneseve të zonës, ku dukej qartë çdo lëvizje e autorëve. Të dyshuarit Robert Perpepaj dhe Ronald Muzhaqi, ndaj të cilëve rëndon akuzat e vrasjes në rrethana të tjera cilësuese ndaj dy ose më shumë personave, kryer në bashkëpunim, kanë mundur ta realizojnë planin e tyre kriminal në më pak se dy minuta.

AKUZAT

Skena e krimit që tronditi kryeqytetin funddhjetorin e vitit që sapo lamë pas u rindërtua nga hetuesit, bazuar në rrëfimet e të mbijetuarve të atentatit dhe pamjeve filmike të kamerave të sigurisë së bizneseve të zonës, ku dukej qartë çdo lëvizje e autorëve. Të dyshuarit Robert Perpepaj dhe Ronald Muzhaqi, ndaj të cilëve rëndon akuzat e vrasjes në rrethana të tjera cilësuese ndaj dy ose më shumë personave, kryer në bashkëpunim, kanë mundur ta realizojnë planin e tyre kriminal në më pak se dy minuta.

I kërkoi gruas seks për t'i dhënë kujdestarinë e fëmijës, KLGJ pezullon nga detyra gjyqtarin Roland Hysi

TIRANË - Një ditë pas arrestimit të gjyqtarit të Fierit, Roland Hysi, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur pezullimin e tij nga detyra. 50-vjeçari i vu në pranga nga policia e Tiranës në bashkëpunim me atë të Fierit, pasi i kërkonte ryshfet dhe marrëdhënie seksuale një nënë të divorcuar, në këmbim të dhënies së kujdestarisë së fëmijës së saj. Gjithashtu, në pranga ka përfunduar dhe sekserja Elona Meçani, e cila është psikologe pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Dy personat në fjalë u prangosën pas skandalit të publikuar mbrëmjen e së martës në emisionin "STOP". Me anë të kamerës së fshehtë tregohet sesi 50-vjeçari Hysi shfaqej duke marrë 500 euro ryshfet dhe kërkonte favore seksuale një gruaje të divorcuar për t'i dhënë asaj kujdestarinë e fëmijës. Ndërsa psikologja 28-vjeçare bënte rolin e sekseres. Ndaj dy të arrestuarve rëndojnë akuzat e "Korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë" dhe "Ushtirimit të ndikimit të paligjshëm të personave që ushtrojnë funksione publike".

Denoncuesja - Unë Roland Hysi - Po pr

VIKTIMA
Në dosjen e prokurorisë thuhet se pas këqyerjes së kufomës së të ndjerës Griselda Gjokolaj ka rezultuar se në anën e djathtë të kokës janë konstatuar dy plagë në anën e pasme të veshit, në një largësi prej 5 centimetra larg njëra-tjetrës. Nga këqyerja e kufomës, në kokën e së ndjerës janë gjetur dhe janë sekuestruar dy predha, të cilat i janë nënshtruar ekzaminimit teknik-balistik për të përcaktuar llojin, kalibrin dhe modelin

"Babalja" u arratis nga Kosova, kërkon azil në Belgjikë
TIRANË - Albert Veliu, i njohur ndryshe si "Babale" apo "Dëshmitari X", për audio-përgjimin e bërë publik disa muaj më parë, është arratisur nga Kosova, ku po qëndronte prej disa kohësh në azil politik. Burime nga prokuroria dje bënë me dije se ai është arratisur nga Kosova në drejtim të Brukselit, ndërsa avokati i Albert Veliu, Tomë Gashi sqaroi për "News24" lajmin e largimit të Klientit të tij nga Kosova. Gashi tha se Veliu është larguar prej disa javësh, pasi u ndje i pasigurt në Kosovë, ndërsa theksoi se tashmë gjendet në Bruksel, ku është bashkuar me familjen e tij. Sipas Gashit, "Veliu ka kaluar më 25 dhjetor në kryeqytetin belg duke iu bashkuar pjesës tjetër të familjes. Ai kërkoi azil politik në Bruksel, për shkak se i rrezikohet jeta", u shpreh Gashi. Ndërkëq, Interpoli ka njoftuar prokurorinë e Tiranës se "Babalja" është arrestuar në Hungari. Veliu pretendon se në Shqipëri i rrezikohet jeta, pasi sipas tij, ai ka denoncuar një rast të trafikut të drogës. Prokuroria shqiptare ka ngritur ndaj tij akuzën për "kallëzim të rremë" dhe "kalim të paligjshëm të kufirit".

SKANDALI REAGIMET

Voltiza Duro

Disa ditë më parë është transmetuar një video ku dëshmohej sesi gjyqtari i Fierit Roland Hysi dhe psikologja Elona Meçani ishin përfshirë në korrupsion dhe skandal seksual. Në një intervistë për 'Gazeta Shqiptare', psikologja klinike msc. Almeida Xhaferi tregon faktorët kryesorë që ndikojnë në zhvillimin e korrupsionit dhe kërkimit të favoreve seksuale. Ajo e konsideron si të pështrirë ngjarjen në fjalë dhe më tej thekson se personat që kanë tipare të natyrës perverse e shfrytëzojnë pushtetin për përfitim ekonomik si dhe për favore seksuale.

Disa ditë më parë është publikuar video ku një psikologe dhe një gjyqtar ishin përfshirë në korrupsion si dhe në një skandal seksual. Si e komentoni ju këtë ngjarje që tronditi opinionin publik?

Së fundmi të gjithë ne të tronditur nga video-skandali i para dy ditëve ku u përfshinë në aferë korruptive një gjyqtar dhe një psikologe, do donim të kuptonim qartazi arsyet objektive që shtynë dy individë të bashkëpunojnë duke thyer jo vetëm ligjin, por mbi të gjitha normat morale. Po e nis nga kjo e fundit. Video skandali në fjalë kishte të gjitha ndjesitë pështrësore brenda, duke filluar nga shfrytëzimi i detyrës për përfitime ekonomike. Përdorimi dhe shfrytëzimi i personave, të cilët të detyrohen për nderin që i bën pjesë në secënç gjyqësore, si profesionistë, pasi nuk zotërojnë aftësi profesionalizmi. Pasi gjyqtari ka në dorë bukën e gojës së psikologëve. A mendoni se gjyqtari në fjalë do pranonte të bashkëpunonte me profesionistë të vërtetë, ku ndërgjegjja profesionale është busulla orientuese në ushtrimin e profesionit? Personalisht dyshoj shumë për këtë. Në këtë moment kemi prekur tërthorazi funksionin e pulsiioneve të brendshme si nxitës të akteve korruptive.

Cilët janë disa nga faktorët që ndikojnë në skandale të tilla dhe sa të dëmshme janë për shoqërinë tonë?

Duke patur parasysh tiparet e personalitetit të personave të cilët kanë pushtet dhe e shfrytëzojnë njëherazi për përfitim ekonomik, si dhe për përm-

Almeida Xhaferi: Skandale të tilla tronditëse, edhe për të mbajtur një vend pune

Video-skandali, psikologja: Rasti tipik, perversiteti përdor korrupsionin

"Njerëzit e pushtetshëm kërkojnë përfitime ekonomike dhe seksuale"

PUBLIKIMI I VIDEOS

Video skandali në fjalë kishte të gjitha ndjesitë pështrësore brenda, duke filluar nga shfrytëzimi i detyrës për përfitime ekonomike. Përdorimi dhe shfrytëzimi i personave, të cilët të detyrohen për nderin që i bën pjesë në secënç gjyqësore, si profesionistë, pasi nuk zotërojnë aftësi profesionalizmi. Pasi gjyqtari ka në dorë bukën e gojës së psikologëve.



Psikologja, Almeida Xhaferi

KORRUPSIONI

Jetojmë në kohë të vështira, ku korrupsioni konsiderohet si bashkëjetues ekzistencial i funksionimit të përditshëm të individit në shoqëri apo edhe në marrëdhëniet ndërvepruese të binomit individ Institucion. Nuk janë të pakta rastet kur kjo gjendje krijon mendësinë se ne, vendi ynë është shtet me nivel të lartë korrupsioni.

PËRMIRËSIMI I SITUATËS

Analistët theksojnë faktin se individë që kanë jetuar në vende me nivel të lartë korrupsioni, pasi zhvendosen në një vend ku niveli i korrupsionit është më i ulët, kanë prirjen të rregullojnë sjelljen e tyre.

njerëz zgjedhin të rrethohen nga persona vulnerabël me tipare neurotike të personalitetit, këtu duhet të kemi parasysh mungesën e besimit në vetvete. Janë njerëz që universi i tyre i brendshëm është i errët plot me objekte të ashpra, të rrethuar nga marrëdhënie relacionale të orientuar drejt konsumit të objektit dhe jo ndjesisë. Perversët zgjedhin pranë vetes të tillë njerëz, pasi vetëm kështu arrijnë qëllimin e tyre parësor të ndërjetit të kënaqësisë përtej barrierave ligjore dhe morale.

Sa ndikon niveli i ulët ekonomik dhe formimi kulturor në zhvillimin e korrupsionit?

Jetojmë në kohë të vështira, ku korrupsioni konsiderohet si bashkëjetues ekzistencial i funksionimit të përditshëm të individ-

pikërisht ligjet që i lënë hapësira dinakërisë njerëzore, por cili është elementi që do na bënte t'i rezistim tundimit? Cilat janë arsyetimet dhe ndjesitë që motivojnë një individ të veproj në kundërshtim me ligjet e shkruara dhe ato të pa shkruara?

Cili është roli i pushtetit në korrupsion dhe sa të frikësuar janë punonjësit përballë presionit për humbjen e vendit të punës?

Tani më dihet, se edhe pushteti në vetvete vepuron si nxitës i sjelljes korruptive. Përvoja na ka treguar jo pak raste ku njerëzit kryejnë veprime korruptive, jo për përfitime ekonomike, por dhe vetëm për të mbajtur një pozicion/vend pune të caktuar. Frika e mospasjes së pozicionit/vendit të punës përbën një nxitës të madh. Me këtë nuk dua të justifikoj sjelljen jo etike dhe aspak profesionale të koleges time. Thjeshtë po përpiqem të analizoj elementet që prodhojnë dhe ushqejnë korrupsionin si fenomen dhe sjelljen korruptive si veprim.

Krijimi i marrëdhënieve shoqërore me persona që kanë pritshmëritë që ti të korruptohesh, apo të abuzosh me detyrën përbën një tjetër

nxitës. Le ta shohim pak më të konkretizuar këtë qasje; dikush që na bënë një nder të madh (na punëson) pret që në një moment të caktuar ne t'ia kthejmë mbrapsht, duke i shërbyer nevojave të tij. Të diskutojmë nëse korrupsioni është faktor kulturor dhe si i tillë i nxitur nga mentaliteti kolektiv i një shoqërie të caktuar, sigurisht që kjo ndikon, por ne deri më sot nuk kemi njohur ende një periudhë historike në të cilën korrupsioni nuk ka egzistuar.

Si mund të veprojmë kolektivisht për të përmirësuar situatën?

Analistët theksojnë faktin se individë që kanë jetuar në vende me nivel të lartë korrupsioni, pasi zhvendosen në një vend ku niveli i korrupsionit është më i ulët, kanë prirjen të rregullojnë sjelljen e tyre. Në këtë kuptim, nëse të gjithë ne ankohemi dhe ndjehemi të pashpresë në këtë vend, pasi përballimi çdo ditë me një realitet të hidhur, ku takojmë të korruptuar dhe përballimi me sjellje korruptive pothuaj në shumicën e institucioneve, nuk duhet të harrojmë që institucionet i përbëjnë vetë ne. Le ta fillojmë ndryshimin nga përgjegjësia jonë personale, duke pranuar pjesën tonë të fajit si qytetar të këtij vendi. Vetëm kështu mund të kryejmë katarsis në ndërgjegjen tonë kolektive.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Akademia e Shkencave pa kryetar, u hapet rrugë zgjedhjeve

Fatmira Nikolli

Asambleja e Akademisë së Shkencave ka marrë dje vendim për të ngritur një komision, i cili do të merret me zgjedhjet e kryesisë së Akademisë. Prej më shumë se një viti, Akademia e Shkencave nuk ka as kryetar, as nënkryetar, ndërsa funksionimi i saj i është lënë në duar (konform ligjit) sekretarit shkencor, Vasil Tole. Duke qenë se Toles i mbaron mandati në muajin shkurt, Akademia që është në proces reformimi, nis punët për zgjedhjet e reja, data e të cilave është në varësi të miratimit në parlament të ligjit që e reformon atë dhe të Kodit të Etikës, që do të kontrollojë punimet shkencore të akademikeve.

MBLEDHJA

Asambleja e Akademisë së Shkencave përmes vendimit të datës 10 janar pas arritjes së kuorumit "Për zgjedhjet e reja të kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe ngritjen e komisionit të administrimit të këtyre zgjedhjeve" ka hapur procedurën e zgjedhjeve për kryesinë e re të ASH-së. Vendimi vjen duke qenë se edhe mandati i të vetmit anëtar të kryesisë dhe njëherësh të vetmit funksionar me fuqi juridike, sekretarit shkencor, përfundon në mbarim të muajit shkurt 2019. Asambleja vendosi të ngrëjë komisionin e zgjedhjeve të përbërë nga 3 anëtarë të saj për të administruar procesin e zgjedhjeve që përfshin: kalendarin me datat, kriteret dhe procedurat e konkurrencimit, pranimin e kandidatuarave, të formularëve dhe të dokumentacionit përkatës, paraqitjen e vizionit të kandidatëve dhe votimin e fshehtë në asambleen e ASH-së. Ky komision do të administrojë të gjithë procesin, deri në votimin e kryesisë së re. Komisioni përbëhet nga akademiku i asociuar Shaban Sinani, akademiku Neki Frashëri dhe akademiku Jani Vangjeli, që është edhe kryetar i komisionit. Asambleja vlerësoi që, megjë projektligji për reformimin e institucionit është në fazën përfundimtare të aprovimit nga Këshilli i Ministrave dhe Kuvendi i Shqipërisë, data e zgjedhjeve të përcaktohet nga komisioni në varësi të hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Takimet dhe mbledhjet e komisionit do të zhvillohen në ambientet e Akademisë së Shkencave. Detyrën e sekretarisë së komisionit e kryen sekretarja e kryesisë së Akademisë së Shkencave, e cila do të dokumentojë të gjithë veprimtarinë e tij. Komisioni i zgjedhjeve informon rregullisht asambleen e ASH-së për të gjitha çështjet që lidhen me mirë organizimin e këtyre zgjedhjeve. Akademia e Shkencave do e mbështet në të gjitha format, veprimtarinë dhe nevojat e funksionimit të komisionit të zgjedhjeve dhe të anëtarëve të tij.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen komisioni i zgjedhjeve, seksionet gjegjëse shkencore të Akademisë së Shkencave dhe nënstrukturat e tjera të saj, përmendur në krye të këtij vendimi.

DEKLARATAT

Pas marrjes së vendimit, Skënder Gjinushi si kryetar i

Vasil Tole: Mandati im si sekretar mbaron në shkurt, nuk e di a do kandidoj



grupit të reformës, tha para mediave se Akademia tashmë ka fatin për të kryer zgjedhjet e kryesisë së re, meqenëse dy anëtarë të kryesisë kanë dhënë dorëheqjen, e tre që janë u mbaron mandati në shkurt. "Siç e dini, Akademia është në proces të një reforme tërësore, që ka filluar me hartimin e projektligjit të ri, që shoqërohet bashkë me projektligjin e pastrimit - dhe po e përdor këtë term meqë është bërë fjalë popullore - erdhë në radhët e doktoraturave të profesorëve me radhë, pra gjithkush që mund të ketë marrë tituj apo grada në mënyrë të pandershme, përmes plagjiaturave". Sipas Gjinushit, megjë janë në këtë proces, janë në rakordim me Këshillin e Ministrave sepse projektet do t'i miratojë qeveria për t'i kaluar në parlament. "Pra, jemi në këtë fazë. Në fund të procesit të miratimit të ligjeve të reja. Gjithsesi, ligji aktual i Akademisë urdhëron bërjen e zgjedhjeve brenda shkurt ose mars. U mor vendim që të ngrihet një komision që të marrë atributet e organizimit të zgjedhjeve dhe çdo gjë pastaj do e përcaktojnë fazat pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Data e zgjedhjeve është në varësi të hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Vetë votimi dhe procesi i tij do të jetë në funksion të hartimit të ligjit të ri", tha Gjinushi. Ai shtoi se nëse ligji i ri vlonohet dhe ka një kompromis që ligji po vlonohet, zgjedhjet të bëhen edhe pa ligjin. "Janë dhënë dy dorëheqje të karakterit moral - për t'u hapur rrugë moralisht zgjedhjeve në Akademinë e Shkencave dhe reformës së saj. Dorëheqjet u dhanë me dinjitet dhe u hap rrugë procesit të reformimit të Akademisë para një viti dhe u hartuan dy projektligjet. Akademia bëri ligjin e reformimit dhe ligjin e pastrimit të vetes, kërkesë tashmë që e kanë

edhe studentët për të gjithë trupin akademik. Përderisa këto janë në proces, Akademia nuk ka më asnjë pengesë për të vijuar reformën. Më e mira është që të konkludohet pas hyrjes së ligjit të ri në fuqi, por është zgjedhje mes palëve", shtoi Gjinushi. Sa i takon opionencës së Fugës, Gjinushi tha se kjo është shenjë e mirë që reforma është në rrugën e duhur.


Skënder Gjinushi: Do kontrollohen punimet shkencore, data e zgjedhjeve në varësi të reformës



asgjë të papërfshirë në ligjin aktual, nuk ka asgjë që nuk është në ligjin aktual. Nuk e kuptoni as ju, as personi jo e jo. E reja e platformës së tij është se na kthen në vitin 2008. Sa herë ka qeveri të re 'rithemelohe' Akademia, gjë që është e papajtueshme", tha Gjinushi. Për të, ka shumë zëra, por zëri nuk quhet ai që bërtet në rrugë, zëri quhet ai që flet me mend. Nga

nuk janë bërë kur t'i mbarojë mandati, quhet ushtrues në detyrë dhe mban funksionet minimale derisa të bëhen zgjedhjet. "Edhe nëse nuk jam unë, do jetë dikush tjetër që Akademisë të mos i krijohet boshllëk. Do bëhen zgjedhje për kryesinë. Nuk ka pse të ketë keqkuptim sepse janë disa detyrime: për të parë dokumentacionin, apo formularët që duhet të plotësohen, për dekriminalizimin apo pastërtinë e figurës. Komisioni do funksionojë në çdo rast".

Tole nuk pati një përgjigje nëse vetë ai do të kandidojë. "Unë mund të vendos që kur të mbarojë mandati të iki apo të rri. Do ta shoh pozicionin tim, sepse ka qenë një vit i vështirë për mua në mungesë të kryesisë". Sa u takon deklaratave të Fugës, Tole tha se e vlerëson mendimin e lirë. "Kemi firmosur në vitin 2016 një dokument që i hap rrugë reformimit. E kam ftuar edhe personalisht Fugën të kandidonte dhe atë vit patëm kandidatuarat që patëm. Nëse duan të ndryshojnë punët, ndryshohen brenda, duke pasur funksione e kompetenca. Grupi i punës që drejtoi Gjinushi ka bërë punë të mrekullueshme, mjafton certifikimi që u bë ligjit nga Akademia Gjermane dhe nga grupimi i akademisë së Shkencave të Europës". Sa i takon akuzës së ligji i ri është plagjiaturë, Tole tha se ligjet, udhëzimet e vendimit e qeverisë nuk konsiderohen plagjiaturë, sepse po marrim standartet më të mira dhe i parapirhet të kohës. "Ligji për etikën në ASHA përfshin edhe akademikët vetë dhe u kemi dalë para kërkesave të studentëve për trupën e profesorëve. Ne sot akademikë me të drejtë vote jemi 30, në mbledhje ishim 20, 6 janë jash-të", tha Tole.



"Kryeministri pati një qasje që të dëgjohej Fuga. Ai e tërhoqi platformën e ne nuk hymë dot më në labirinte. Ai thotë që e ka dorëzuar në Ministrinë e Arsimit, atje le ta kërkojë. Ne nuk jemi ministri. Ai e ka çuar deri te kryeministri. Ai e ka tërhequr dhe atë që ka propozuar më pas, nuk është asgjë më shumë se ç'shitje. Këtu janë 40 akademikë, që ndër vite kanë sjellë 15 platforma. Nuk ka

ana tjetër, sekretari shkencor i Akademisë së Shkencave tha se gjatë këtij viti, asambleja ka punuar me qeverinë dhe Ministrinë e Arsimit për të përfunduar projektligjet e reformës. "Ka një prognozë që ky proces të mbyllet në muajin mars. Nëse ndodh kjo, komisioni do ta caktojë datën e zgjedhjeve kur ligji i ri të ketë hyrë në fuqi". Sipas Toles, ai si sekretar shkencor nëse zgjedhjet

Film apo regjiturë? Binom magjik, ja kur del projekti i fundit

Paragjykojnë për stilin, flet aktorja Evisa Budini

"Prapaskenat janë momentet më të bukura"

Egla Xhemali

Film quhet prodhimi au diovizual që përmban një sasi planesh filmike të ndërlidhura, të shoqëruara me zë apo jo, të cilat krijojnë efektin e lëvizjes, duke pasur një harmoni unikalë ndërmjet formës dhe përmbajtjes. Për Evisa Budini, aktoren në moshë të re është e vështirë zgjedhja mes filmit dhe regjiturës. Në një rrëfim për "Gazeta shqiptare", Budini tregon për skenat më të vështira për tu realizuar, ofertën më të çuditshme që ka marrë për hir të punës, kritikën dhe për projektin e ri që ka në duar. Sipas saj stili është mjaft i rëndësishëm për aktorin pasi në një farë mënyre përfaqëson karakterin e tij. Evisa ndan me ne dhe momentet kur del nga vetja. Duke qeshur pohon se largohet nga situata. Budinin është tepër energjike e kjo ia bën asaj më të lehtë punën si aktore. Më tej, Evisa zbulon projektin që shumë shpejt do të vij në skenë dhe aktorët me të cilët po punon. Çdo zgjedhje që ndjek pasionin rezulton e suksesshme. Tanimë Evisa i është futur asaj rrugë.



Kur xhirohet një film, cila është gjëja e parë që të vjen në mend?


Kur xhirohet një film gjëja e parë që më vjen ndër-

mend janë prapaskenat. Ato janë momentet më të bukura.

Skenat më të vështira për t'u realizuar?

Personalisht në filmin e fundit kanë qenë momentet ku koha s'ka qenë aspak e butë me ne, në të ftohtë.

Mes aktrimit dhe regi-



surës cilën do zgjidhje?

Uhh nuk do t'i ndaja. Të dyja kanë magjinë e vet.

Oferta më e çuditshme që të është bërë për hir të

punës?

Më kanë ofruar të punoj në TV pa pagesë. Ndjesë po kjo është më shumë se e çuditshme, absurde fare.

Sa rëndësi ka stili për të identifikuar një aktor?

Stili dhe paraqitja identifikojnë çdo njeri. Për një aktor a një person publik ka patjetër shumë rëndësi pasi përfaqësojnë një pjesë të karakterit.

Kritika më e ashpër që ke marrë për veten?

Hiperaktiviteti. Në horoskop jam binjakët.

Deri ku shkon kur del nga vetja?


Kam frikë se nuk e kap dot më. (qesh) Përpiqem të largohem nga situata.

Si është shpresa për një ditë të re, më të mirë për ty?

Të jem me projekt në teatër dhe të kem një pagë frymëzuese. Këtë e theksoj sepse momentalisht më duhet të merrem me disa projekte njëkohësisht që t'ia dalë.


Projekti që ke në duar? Kur do vijë për publikum?

Tani jam duke punuar për të vënë në skenë një komedi të zezë "Vetmi në perëndim" nga Martin MC Donagh, me një kast aktorësh shumë të talentuar si: Josif Sina, Aleksandër Prodan, Hysen Mehmeti dhe ëmbëlsira Elona Mamo. Shpresoj që pas një muaji të jemi gati, por deri atëherë kemi shumë punë për t'ia arritur.




"Të dua përjetë", Oriola Marashi bën dedikimin e ngrohtë për njeriun e zemrës

Ajo vazhdon të jetë tejet aktive në rrjetet sociale, me anë të postimeve të saj të shumta dhe sidomos fotot provokuese, që tërheqin gjithmonë vëmendjen e ndjekësve. Ditën e djeshme, një tjetër postim ka marrë vëmendjen e fansave të saj. Nëpërmjet disa fotove në 'Instastory', Oriola i ka uruar ditëlindjen mikut të saj më të shtrenjtë, Endrit Mërtirit. "Shokë të ngushtë përjetë. Gezuar ditëlindjen shoku im që prej ditës së parë, të dua përjetë. Të kesh një shok të vërtetë është gjëja më e mirë që një person mund të ketë. Jam e lumtur për sa kohë të kam pranë meje. Gjithmonë bashkë."- shkruan Oriola në postimet e saj.




Nuk do ta njihni! Era Istrefi bëri ndryshimin e radhës

Këngëtarja e famshme Era Istrefi është një ndër artistet më të pëlqyera nga publiku me zërin e saj të veçantë dhe stilin e të veshurit. Asaj i pëlqen të luajë me pamjen e saj. Nga një vajzë me flokët "rasta", e më pas bionde, ngjyrën e flokëve e ka pasur edhe rozë njëkohë dhe më pas u shndërrua në zeshkane. Tani Era sërisht e ka ndryshuar pamjen duke ardhur me një tjetër stil e ngjyrë flokësh. Me anë të një postimi në 'Instastory', ndryshimi në imazhin e Erës është i dukshëm. Këngëtarja ka prerje të re, ndërsa flokët kësaj here i ka bërë me hijezime ngjyrë karamelle.



"Babë e bijë jeni apo bashkëshortë?" Modelja e njohur i habiti të gjithë me reagimin e saj

Modelja e famshme Emina Çunmulaj vazhdon të jetë tejet aktive në rrjetet sociale duke publikuar vazhdimisht imazhe të këndshme nga jeta e përditshme. Mirëpo, teksa ka pozuar me bashkëshortin, asaj i ka tërhequr vëmendjen një koment jo fort i këndshëm i një ndjekëseje. "Më falni çfarë janë, babë e bijë apo bashkëshortë?", i shkruan ajo, të cilës Emina ja ka kthyer: "E ti këtë në foto çfarë e ke, gjysh?", përgjigje që me siguri e ka lënë ndjekësen me gisht në gojë, duke mos vazhduar me pas me komente të tjera.



Loredana poston imazhet e Hanës së vogël, zbuloni si duket ajo

Vogëlushja e çiftit të njohur Loredana dhe Mozzik është në qendër të vëmendjes nga adhuruesit e këngëtarëve. Është bërë zakon tashmë që të gjitha bebeve t'iu realizohen 'fotoseSIONE' që t'iu mbeten si kujtim. Dhe këto seri fotografish tejet të ëmbla, sa vijnë e bëhen më të bukura, më kreative e profesionale. Të dy këngëtarët Mozzik dhe Loredana janë kujdesur që vogëlushja e tyre të ketë një fotoseSION ende pa i mbushur 2 muaj. Imazhet e realizuara për Hanën janë shumë të këndshme. E shtrirë në një batanije, vogëlushja është rrethuar me lule shumë ngjyrëshe që e bëjnë të duket e adhurueshme.



Kryeministri grek: Zgjedhje të parakohshme, nëse Kamenos favorizon kundërshtarin

Kryeministri grek, Alexis Tsipras, ka thënë se dështimi i Marrëveshjes së Prespës dhe një shpërbërje e Maqedonisë mbart rrezikun e krijimit të Shqipërisë së Madhe. Tsipras tha se pakti Athinë-Shkup u shërben interesave të Greqisë. "Greqia nuk ka asnjë interes nga një destabilizim në kufijtë e saj veriorë. Nuk ka asnjë interes të ketë një front të hapur në një vend që do të mund të ishte një hapësirë jetike për ekonominë dhe bizneset tona. Nuk ka asnjë interes nga shpërbërja e atij vendi dhe mundësia e një 'Shqipërie të Madhe' në kufijtë tanë". Në një intervistë për mediat vendase, Tsipras tha se Marrëveshja e Prespës do ta ketë rrugën e hapur në parlamentin grek dhe se ajo është arritja më e rëndësishme e qeverisë së tij pas daljes së vendit nga kriza ekonomike. "Mendëherë pasi të votohet në parlamentin e Shkupit, qëllimi ynë është ta sjellim Marrëveshjen e Prespës në parlament, natyrisht brenda muajit janar". I pyetur rreth një refuzimi të mundshëm të marrëveshjes nga "Grekët e Pavuar" të Panos Kamenosit, kryeministri pohoi se në atë rast do të kërkojë mbështetjen e parlamentit. "Besoj se z.Kamenos nuk do të zgjedhë të favorizojë kundërshtarin tonë. Por nëse e bën, unë do të kërkoj votëbesim nga parlamentin. Nëse nuk marr shumicën prej 151 deputetësh, kemi një problem politik, jo kushtetues dhe atëherë do të thërras zgjedhjet e parakohshme". Marrëveshja historike mes Athinës dhe Shkupit, e firmosur në Prespë në qershor, pritet të ratifikohet brenda 15 janarit në parlamentin e Maqedonisë. Ndërkaq, kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev ka deklaruar se ende është në bisedime me lëvizjen "Besa" të Bilal Kasamit për gjetjen e formulimit teknik lidhur me shtetësinë, me qëllim të sigurimit të 80 deputetëve të nevojshëm për miratimin e amendamenteve kushtetuese. "Besa" është parimisht e vendosur për këtë

Tsipras: Krijohet "Shqipëria e Madhe", nëse shpërbëhet Maqedonia

Zoran Zaev: Pse s'rrezikohet identiteti



Kryeministri Grek, Alexis Tsipras

çështje, siç janë edhe të tetë deputetët e VMRO-DPMNE-së dhe koalicionit dhe janë të parët për mbrojtjen e identitetit të Maqedonisë". "Besa" nuk kërkon të ndryshohet identiteti apo ngjashëm. Syri i zgjuar i tetë deputetëve këtë po bën si në dhe deputetët e tjerë. Po punojmë që të gjendet zgjidhje për formulimet teknike si shtetësia për të gjithë të jetë maqedonas/qytetarë të Republikës së Maqedonisë Veriore, ndërkaq megjithatë, shqiptarët dhe bashkësitë e tjera etnike të mos jenë maqedonas", tha Zaev në konferencën për shtyp pas promovimit të operatorit të autorizuar ekonomik. Ai shtoi se maqedonasit nuk

duhet të frikësohen se ndonjë parti shqiptare apo deputet shqiptar që kërkon të rrezikohet identiteti. "Të gjithë angazhohemi që ai identitet, që ishte kontestuar përfundimisht të jetë i garantuar. Shqiptarët e bënë atë edhe në referendum, edhe me mbështetjen për Marrëveshjen e Prespës, njëkohësisht edhe me maqedonasit nuk kemi për qëllim që ndonjë ndjenjë apo përkatësi etnike ta ndryshojmë. Ato janë vlera dhe të drejta njerëzore", tha kryeministri. Zaev përsëriti se numri i përgjithshëm i deputetëve, të cilët do t'i mbështesin amendamentet kushtetuese do të dihet në momentin e votimit.

Vijon greva, minatorët e Trepçës: Do vazhdojë deri sa të plotësohen kushtet

Minatorët e kombinatit metalurgjik të Trepçës në Kosovë kanë hyrë në ditën e shtatë të grevës. Ata thonë se greva do të vazhdojë deri në plotësimin e kushteve të kërkuara. Minatorët janë duke kërkuar rritjen e pagave me 20 për qind, shkarkimin e bordit të këtij kombinati, ndalimin e punësimit të stafit pa konkurs dhe krijimin e kushteve më të mira për punë. Punëtorët po ashtu po kërkojnë të miratohet sa më shpejt statuti i Trepçës, ashtu siç parashihet në Ligjin për Trepçën. Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Trepçës, Shyqyri Sadiku, tha për Radion Evropa e Lirë se janë në pritje të plotësimit të kushteve, për të cilat kanë hyrë në grevë. "Greva është duke vazhduar, jemi në pritje. Bisedimet që kemi pasur me ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Luka, për dy pika të kërkesës i kemi përfruar. Sa i përket pikës një, që është rritja e pagave dhe pikës dy, që është shkarkimi i bordit, nuk kemi arritur marrëveshje dhe jemi në pritje. Ne do të jemi në grevë deri në realizimin e kërkesave tona", tha Sadiku. Ministri i Zhvillimit Ekonomik në Qeverinë e Kosovës, Valdrin Luka, të mërkurën ka kërkuar nga minatorët që të ndërpresin grevën, duke ua bërë me dije se nuk mund të ketë rritje të pagave. Luka ka thënë për Radion Evropa e Lirë se rritja e pagave për 20 për qind aktualisht është e pamundur, për shkak të gjendjes së rëndë financiare në këtë kombinat. Kurse sa i përket kërkesës për shkarkimin e bordit, Luka ka thënë se për këtë çështje vendos qeveria.



Komisioni Europian do hetojë Kosovën për çmimin e naftës

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës ka njoftuar se javën e ardhshme do të ndihmojë nga ekspertët nga Komisioni Evropian lidhur me pretendimet se në Kosovë është krijuar një kartelë i ndërmarrjeve që kanë mbajtur lart çmimin e naftës, shkruajnë mediat kosovare. Valon Prestreshi, drejtor i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, ka thënë se tashmë kanë "të gjitha informatat relevante nga institucionet përkatëse rreth shqetësimeve të ngritura nga qytetarët, mediat dhe shoqëria në përgjithësi rreth pretendimeve të tyre rreth një karteli potencial të ndërmarrjeve, të cilat afrojnë me derivate të naftës". "Këto informata janë duke u përmunuar me shumë kujdes nga hetuesit tanë, bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, gjithashtu nga java e ardhshme do të marrim ndihmë edhe nga ekspertët e Komisionit Evropian, ku ne si Autoritet jemi përfitues të projektit IPA dhe gjatë javëve në vijim Autoriteti do të dalë me raportin përfundimtar", ka njoftuar ai. AKK po ashtu ka njoftuar për Programin e Lehtësive, Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, përkatësisht nën 60, që parashihet se mund të lirohet ose zvogëlohet masa ndëshkuese e ndërmarrjeve në ato: "Me qëllim të zbulimit të shkeljeve me të rënda të këtij ligji, Autoriteti mund të lirojë nga masa ndëshkuese atë pjesëmarrës në marrëveshjet e ndaluar horizontale-kartelë, i cili e njofton i pari Autoritetin për kartelin dhe i ofron të dhëna e fakte dhe prova, të cilat i mundësojnë fillimin e procedurës ose pjesëmarrësit të parë në kartelë, që Autoritetit i ofron prova që mundësojnë konstatimin e shkeljes së këtij ligji, në rastet kur Autoriteti ka filluar procedurën, mirëpo nuk ka pasur fakte të mjaftueshme për përfundimin e saj ose konfirmimit të kartelit".

Haradinaj: Dogana ka mbledhur mbi 65% të buxhetit të Kosovës

Kryeministri kosovar takon drejtorin Berisha, buxheti i 2019-ës llogaritet 2.3 mld euro

Kryeministri i Kosovës ka thënë se doganat e Kosovës kanë mbledhur të hyra mbi 65 për qind të buxhetit të shtetit. "Është me rëndësi të theksohet se dogana si institucion ka mbledhur për buxhetin e vendit mbi 65 për qind të buxhetit në total. Janë 582 pjesëtarë të agjencisë së doganave dhe misioni i tyre është me të vërtetë i rëndësishëm. Pra, nuk është vetëm punë e zakonshme; është buxheti, është siguria kombëtare, por janë edhe të gjitha ato informatat e nevojshme për trendet ekonomike", ka thënë Haradinaj në një komunikatë drejtuar mediave. Këto komente Haradinaj i ka bërë



RAMUSH HARADINAJ

"Është me rëndësi të theksohet se dogana si institucion ka mbledhur për buxhetin e vendit mbi 65 për qind të buxhetit në total. Janë 582 pjesëtarë të agjencisë së doganave dhe misioni i tyre është me të vërtetë i rëndësishëm. Pra, nuk është vetëm punë e zakonshme, është buxheti, është siguria kombëtare, por janë edhe të gjitha ato informatat e nevojshme për trendet ekonomike", është cituar të ketë thënë Haradinaj.

in e përgjithshëm e këtij institucioni, Behri Berisha. Në anën tjetër, drejtori i doganës, Bahri Berisha ka

thënë se e ka informuar kryeministrin Haradinaj për punën që ka bërë ky institucion gjatë vitit 2018, si dhe

për "të arriturat që i kanë pasur në fushën e të hyrave, luftën e ekonomisë informale, krimin transkufitar të kontrabandës, por edhe shumë procese, siç janë reformat që është duke zhvilluar dogana", është bërë e ditur në komunikatë. Në këtë vizitë Haradinaj ishte i shoqëruar nga ministri i Financave, Bedri Hamza, i cili ka deklaruar: "Doganat janë prej kontribuuesve më të mëdha të buxhetit të Kosovës. Dy institucionet që kontribuojnë më me të shumti të hyra në buxhetin e shtetit janë doganat e Kosovës dhe administrata tatimore. Buxheti për vitin 2019, i cili pret miratimin në leximin e dytë në Kuvend, vlerësohet se do të jetë 2,3 miliardë euro".

Nga roli si ushtar, te qenia pjesërisht hebre, jeta e arkitektit të Luftës së Dytë Botërore

Të vërtetat e "diktatorit" të dobët, Adolf Hitler

Teoritë konspirative më të diskutueshme mbi tmerrin e Europës

Nga James Friend

Adolf Hitleri është figura historike më e shëmtuar, por ndoshta edhe më e fuqishme e saj. Ai ishte më shumë se cilido tjetër, arkitekti i Luftës së Dytë Botërore, një konflikt që ndryshoi botën përgjithmonë. Udhëheqësi nazist ka qenë subjekt i shumë librave, filmave dhe dokumentarëve se çdo individ tjetër, i gjallë apo i vdekur. Megjithatë, pavarësisht nga ky interes intensiv dhe i qëndrueshëm, ka ende shumë gjëra mbi Hitlerin, të cilat ne nuk i dimë me siguri. Ja cilat janë 10 nga teoritë më të debatuar mbi jetën dhe vdekjen e Fyrrerit.

Ai ishte Hitleri një ushtar trim?

Historia thotë se ai ishte një ushtar trim, që rrezikonte periodikisht jetën. Ky ishte sigurisht versioni i historisë i paraqitur nga nazistët, por studimet e fundit sugjerojnë se trimëria e tij në Luftën e Parë Botërore mund të jetë zmadhuar shumë.

Dr. Tomas Ueber i Universitetit Aberdin në Skoci, ka studiuar çdo ditar apo letër që gjeti të shkruara nga ushtarët, që kishin shërbyer në regjimentin e Hitlerit. Ai zbuloi se Hitleri angazhohej kryesisht në përcimin e informacioneve nga fronti tek shtabi qendror, një detyrë që e zhvendosë disa kilometra pas linjave të para të betejave.

A ishte Hitleri pjesërisht hebre?

Detajet e pemës familjare të Adolf Hitlerit nga e ëma dihen mirë. Por s'mund të thuhet e njëjta gjë të atin. Alois Shiklgruber, që më vonë e ndërroi mbiemrin e tij në Hitler, ishte një fëmijë jashtë martese. Askush nuk e dinte se kush ishte i ati i Shiklgruber. Historianët janë përpjekur shumë të zbulojnë identitetin e vërtetë të gjyshit të Adolf Hitlerit. Misteri nuk është zgjidhur kurrë, por një nga kandidatët potencialë është një hebre me emrin Leopold Frankenberger. Nga rezultati i AND-së së 39 prej të afërmeve të Hitlerit që i mbijetuan luftës, rezultoni se ai e ka prejardhjen pjesërisht nga berberët e Afrikës Veriore dhe popullit hebre.

A ishte një ushtar britanik që i kurseu jetën e Hitlerit?

Henri Tandey ishte një hero lufte, një nga ushtarët më të dekoruar në ushtrinë britanike dhe ndoshta njeriu që pa dashje humbi një mundësi të artë për të parandaluar Luftën e Dytë Botërore. Legjenda thotë se Tandey dhe Hitler



Adolf Hitler

u takuan ballë për ballë në një fushë betejë të Luftës së Parë Botërore. Thuhet se britaniku e mëshiroi dhe e la të largohej Hitlerin e paarmatosur dhe të plagosur. Në shtatorin e vitit 1938, kryeministri britanik, Nevil Chamberlen, shkoi në Gjermani në një përpjekje optimiste, por në fund të dështuar, për të siguruar paqen në Evropë. Ai vuri re një fotografi të një ushtari britanik, Henri Tandey, në muret e studios së Hitlerit. Fyheri shpjegoi se ai e kishte parë foton e Tandey në një gazetë dhe e njohu atë si njeriun që i kurseu jetën gjat Luftës së Madhe. Ndoshta Hitleri mund të ketë gabuar. Ndoshta ai e shpiku historinë për të forcur mitin e tij si një njeri të mbrojtur nga fati. Megjithatë, Tandey e konfirmoi vetë se u kishte kursyer jetën disa ushtarëve gjermanë. Ka gjasa që njëri prej tyre të ketë qenë Adolf Hitleri.

A ishte Hitleri një diktator i dobët?

Në kulmin e fuqisë së tij, Adolf Hitleri udhëhoqi një perandori të madhe, që shtrihej pothuajse në tërë Evropën kontinentale dhe një pjesë të madhe të Afrikës së Veriut. Imazhi konvencional i Hitlerit, është ai i një sundimtari në qendër të këtij rrjeti të gjerë, që merrte të gjitha vendimet e rëndësishme dhe tërhiqte nga lart të gjitha fjet. Mbështetësit e teorisë së një diktatori të dobët e pranojnë se Hitleri ishte njeriu më i fuqishëm në Rajh. Por ata argumentojnë se ai qe i paaftë të ushtronte llojin e kontrol-

lit të drejtpërdrejtë ndaj vartësve të tij, sikurse Josif Stalini në Bashkimin Sovjetik.

A ishte Hitleri i obsesionuar pas okultizmit?

Disa nga pjesëtarët e rrethit të ngushtë të Hitlerit besuan fuqishëm në fuqinë e mbinatyrshme dhe magjinë. Hajnri Himler krijoi një njësi të posaçme brenda SS, për të mbledhur informacione mbi magjinë, ndërsa marioni gjermane ngriti madje Institutin Kombëtar të Pendulimit në Berlin. Ndërsa britanikët përdornin sonarin për të gjurmuar nëndetëset së gjermane, gjermanët u përqopën t'i gjenin anijet britanike, duke përdorur lavjerrsin mbi hartat e Oqeanit Atlantik. Sesa ishte i bindur Hitleri në ekzistencën e fuqive të mbinatyrshme, kjo është e diskutueshme. Megjithatë, s'ka dyshim që ai fliste shpesh për një forcë, që ai e quajti "providencë", e cila e mbronte atë dhe udhëzonte veprimet e tij.

A ishte Hitleri një përdorues droge?

Adolf Hitleri nuk pinte duhan, alkool dhe nuk hante mish. Ai madje nuk konsumonte as kafe. Propaganda naziste e portretizoi atë si një njeri të përkushtuar gjithë jetën e tij në shërbim të Gjermanisë: ai s'kishte as kohë dhe as prirje të ndiqte kënaqësitë tokësore. Por realiteti ishte se Hitleri e kaloi pjesën më të madhe të luftës i drogim me një koktej të tmerrshëm lëndësh narkotike. Në fillim të vitit 1945, fabrikat që prodhonin

medikamentet me të cilat ai mbahej në këmbë u shkatërruan nga bombarduesit aleatë. Hitleri nisi të dridhej gjithnjë e më shpesh, dhe jo sëmunda e Parkinsonit siç është hipotetizuar shpesh, por nga mungesa e barnave, gjë që e përkeqësoi gjendjen e tij mendore dhe fizike, kur lufta në Evropë po i afrohej fundit.

A i mbijetoi Hitleri luftës?

Nga të dhënat e dimë me shumë siguri se Hitleri ndodhej ende në Berlin në ditëlindjen e tij, më 20 prill 1945, vetëm 2 javë para se qyteti të kapitullonte. Kur kjo ndodhi, policia sekrete e Stalinit e pengoi marshallin Zhukov, komandantin e lartë sovjetik në të gjithë Frontin Lindor, të inspektojë bunkerin e Hitlerit nën kancelarinë e Rajhut. Kur mbërritën amerikanët dhe britanikët, Hitleri, qoftë i gjallë apo i vdekur, ishte zhdukur prej kohësh. Me mungesën e ndonjë mbetjeje fizike për të shqyrtuar, FBI dhe CIA fillimisht mbetën të hapura ndaj skenarit që Hitleri mund të kishte shpëtuar gjallë. Dhe kjo nuk qe aspak e paimagjinueshme, por provat e shumta tregojnë që ky nuk ka të ngjarë të ketë qenë rasti. Dhjetëra dëshmitarë okularë konfirmojnë praninë e Hitlerit në Berlin kur Ushtria e Kuqe gjendej shumë pranë bunkerit të tij. Nëndetësja për të cilën u tha se u arratis, u gjet më vonë e fundosur në Detin e Veriut midis Danimarkës dhe Norvegjisë. Këtë vit, Arkivi Kombëtar i Rusisë, i lejoi ekspertët të studiojnë një palë dhëmbë që thuhej se



Britani, vizitohet për sytë, por del me tumor në tru 19-vjeçarja

Shkoi tek mjeku për të bërë një vizitë të syve, por mësoi se kishte kancer në tru. Një 19-vjeçare është shokuar teksa mjekët i kanë thënë se ka disa tumore në tru. Laura Nuttall, nga Lancashire, Britani në fillim mendoi se kishte grip, por kur iu nënshtrua një vizite sysh, mjekët vunë re një ënjtje të pashpjegueshme në nervin e saj optik. Më pas doktorët e rekomanduan të bënte dhe disa analiza të tjera. Laura Nuttall telefonoi nënë e saj Nicola dhe shkuan në spitalin Horlerton, ku dhe morën lajmin shkatërrues se ajo kishte dy tumore. E reja iu nënshtrua edhe një skanerit të detajuar dhe mjekët zbuluan se ajo kishte dhe disa tumore të tjerë, jo vetëm 2 sikurse i kishin thënë në fillim. "Jemi shkatërruar si familje, Laura kishte gjithë jetën përpara dhe tani po përballlet me një sfidë shumë të rëndë. Ne po përpigemi të jemi pozitivë, por është pamundur", ka thënë nëna e saj, shkruan "Daily Mail". Nicola po bën gjithçka që mundet për të ndihmuar Laurën që ta largojë sadopak mendjen nga sëmundja. Në ditëlindjen e 19-të në dhjetor, ajo vizitoi lojtarët e klubit të futbollit të Everton ku u takua me ata, përfshi dhe portierin Jordan Pickford. "Po provoj gjithçka për të ndihmuar që Laura të ndihet pozitive. Ne po bëjmë aq sa mundemi", ka thënë Nicola. Laura iu nënshtrua kimioterapië gjatë muajit dhjetor në spitalin Chrisit në Manchester, por edhe në muajt në vijim do të vazhdojë seanca të tjera. Familja e saj po mendon që ta dërgojë atë në SHBA, për t'u nënshtruar disa seanceve kimioterapie. Gjithashtu, ata kanë nisur një fushatë për të mbledhur fonde që Laura t'u nënshtrohet trajtimeve më të specializuara, në mënyrë që t'i japin asaj dhe një shans për të jetuar.



Porosi nga Brazili "Fruta të thata" 500 mijë euro në Greqi, policia sekuestron kokainën

Policia greke ka shkatërruar një organizatë ditën e mërkurë në Athinë, pasi u sekuestruan drogës me kokainë nga Brazili. Sipas shtypit grek, të fshehura brenda paketimit të frutave të thata ishin 36 kilogramë kokainë të ndara në disa pako. Lënda narkotike u sekuestrua gjatë një operacion antidrogë të zhvilluar në disa zona të Athinës. "Frutat e thata" ishin dërguar nga Brazili me transport ajror drejt Greqisë. Vlera e kokainës së pastër përlogaritet në rreth 500 mijë euro. Në pranga kanë rënë 6 persona, por në kërkim janë tre të tjerë që konsiderohen kyc. Në mesin e tyre është edhe një grek që jeton në Brazil, i cili dyshohet se mban lidhjet me kartelët e drogës atje dhe ka nisur dërgesa drejt Athinës. Autoritetet thonë se bëhet fjalë për të njëjtën spirale droge kur 6 muaj më parë në Gjermani u arrestua një shqiptar, që është financuesi dhe drejtuesi i kësaj organizate. Dyshohet se edhe ai drejton nga burgu trafikun ndërkomëtar të lëndëve narkotike.

i përkisnin Hitlerit. Një ekip patologësh francezë i krahasoi ato me një grafi të dhëmbëve të Hitlerit në vitin 1944 dhe gjeti një përputhshmëri të madhe. Gjithsesi, thashethemet se ai u arratis në Amerikën e Jugut apo edhe në Antarktidë nuk vdesin lehtë.

Marrë nga Bota.al

Opinion i Ditës

Baton mafija dhe Shqipëria si një OJQ e tij

Nga Kimete Berisha

Nga tavolina e tij e Zonës B, që me qëllim e ka improvizuar të duket si i ulur mbi varrin e peygamberit në Mekë, Baton Haxhiu e krijon 'njeriun e ri', krijon 'ministra', 'maron' intelektual, e i vendos politikatat shtetërore të Shqipërisë, njeriu që në Kosovë s'e merr kush seriozisht për kurrëgjë, përveç për spiunazh.

Spiunët e Serbisë dhe mbetjet e Sorosit që kanë dështuar me marrë në dorë Kosovën, po bëjnë 'kërdi' në Shqipëri.

Nëse asnjë vlerë nuk e kanë pas kurrë Hashim Thaçi e Ramush Haradinaj, mjafton që mbeturinave të Serbisë e të Sorosit nuk u kanë lënë vend, thjesht spiunët i kanë shfrytëzuar për spiunazh e jo si Edi Rama që shkon e 'dashurohet' në ta.

Edi Ramës i pëlqejnë biondinët, e kuptoj se edhe mua gjithmonë më kanë pëlqyer më shumë biondët.

A mundesh me marrë me mend ti sa ultë ka ra Shqipëria, kur Baton Haxhiu i drejtohet si qenit presidentit të Shqipërisë, një të dytën i thotë 'Ilir', ngoje ti Batonin.

Thuajse e ka grua e jo president.

Batoni luan rolin e mafijashit me alltija të huja.

Ndërhynë privatisht në qeverinë e Shqipërisë dhe e trajton Presidentin Ilir Meta si kryetar të OJQ-së e jo si kryetar të shtetit, se Shqipëria nuk i duket shtet, po i duket si 'grup mafioz'.

Plus Iliri ma i ri se Batoni, s'e merr seriozisht.

S'e njoh Cakën, as s'kam dëgjuar kurrë për të derisa iu përmend emri për ministër, pastaj e ngova pak në debat te Batoni dhe e pashë që e kish humb rrugën në terminologji, ish aq i ngarkuar me gramatikë sa kujton si ata 'intelektualët' e moçëm se sa më i pakuptuar që je aq më shumë të respektojnë.

Sofizma të lodhshme si ky i tipit 'operacioni lingvistik', demokracia e kufirit mes Kosovës e Serbisë nuk është 'semantikë', nuk është gramatikë, por është 'daha-përmirë'.

Ky është për ndarje të Kosovës, plus mjafton kush e do atë për ta kuptuar kush është ai.

Dikë që e do Baton Haxhiu e Edi Rama, nuk i ka punët mirë. Këta i duan vetëm ata që mund t'i shkelin dhe t'i përdorin.

Por janë edhe pak do veta që u tutën këta, e s'guxojnë as emrat me ua përmend.

Edi Rama s'ia del të përmbahet kur ia refuzojnë dikë që e adhuron, e shihni si u çmend për Cakën, sepse kjo i ndodh rrallë, aq rrallë i pëlqen dikush sa merrzitet shumë kur nuk i shkon zari, dhe edhe në këtë pikë e kuptoj se



edhe mua më ndodh shukë rrallë me m'pëlqy dikush, veç Batoni din me kajt si çikat, din edhe m'u hakmerr por tutët. Mban ymyd që del dikush që hakmerret për të.

Plus Batoni e ka kompleksin e moshës dhe të kohës, prandaj i ngutet për gjithçka, e zbulon gramatikën e tij e varfër kur thotë 'Ilir, ngutu'.

Sipas Batonit m'i refuzo propozimin e Batonit për ministër të Jashtëm të Shqipërisë është gabim historik, q'aq ka lu' ky.

Batoni ka kujtuar se duke e pasur njeriun e tij ministër të Jashtëm të Shqipërisë, e ndajnë Kosovën si gjaja e gjallë, plus nuk i mbetet faji Edi Ramës, po i mbetet faji ministrit nga Kosova, të cilin Kosova nuk e njeh m'i pa në rrugë.

S'e njoh Cakën, as s'kam dëgjuar kurrë për të derisa iu përmend emri për ministër, pastaj e ngova pak në debat te Batoni dhe e pashë që e kish humb rrugën në terminologji, ish aq i ngarkuar me gramatikë sa kujton si ata 'intelektualët' e moçëm se sa më i pakuptuar që je aq më shumë të respektojnë.

Goditje të ulta, nivel tepër i varfër i imagjinatës, sikurse ka vepruar edhe me Besa Shahinin, mbesën e Ibush Kllokoqit (i angazhuar në sigurimin shtetëror serb për t'i torturuar të burgosurit politikë shqiptarë, si Adem De-

maçin, për shembull).

Mendja e Edi Ramës iu vjen keq studentëve të Shqipërisë prej ministres nga Kosova e i ndalin protestat e zullumin ndaj tij.

Po ku gjen ti në ditë të sotit keqardhje!

Po, ndoshta edhe ju kish ardhur keq studentëve shqiptarë prej ministres nga Kosova me pas qenë ajo Saranda Bogujevci apo Besarta Jashari.

Por, prej Besa Shahinit, mos t'ju vjen keq hiç pse është e Kosovës, se nuk është e Kosovës, është e Sorosit, i cili po ashtu ka dështuar ta marrë Kosovën në dorë e të vendosë kush të bëhet ministër, sic vendos në OJQ-Shqipëria e Edi Ramës.

Se harrova, Batonit krejt i duken të vjetër, përveç meje! Batoni më pat refuzuar me shkru komentet politike në 'Gazetën Ex-

press', me idenë se isha 'shumë e re për politikë' i ka pas thënë 'njanit' veç nëse don ajo çika me shkru për filma e për rubrikën e kulturës...me pas qenë djalë biond jam qind për qind e sigurt se nuk kisha me qenë aq e re, plus e kisha pasitë për paragjykim dhe diskriminim për shkak të moshës.

Nuk e kuptuam se çfarë bukurie 'fizike, shpirtërore ose mendore' sheh Edi Rama te Batoni, që qe sa vjet tranohet pas tij, e nuk e ka ndërru me asnjë më të mirë, por si duket 50% i

ka ra niveli i dashnisë për të, po del se Batoni u shfrytëzua ma në fund edhe nga Edi Rama, i cili në këtë rast patjetër del njëfarë pseudo-fituesi, sepse i bie që Edi Rama po mundohet me na afruar neve shqiptarëve, por s'po e lë Iliri, i cili i merr vendimet natën në shtrat, qaq Kim Kardashian është Monika.

Gjynah, as Batoni nuk e ka lehtë, se u rritë tuj e këqyr babën e vetë tuj shku para lindjes dhe mbas përdimit të diellit në policinë serbe me librat e shkrimtarëve shqiptarë e sidomos 'Bregun e pikëllimit' nën sqetull, për m'i analizuar 'policia serbe e shpirtit'.

P.S. Ndoshta edhe po shkruaj me inat, ndoshta s'po mundem me ndal veten, por fati është fat, kur s'e don s'e don...e dikur s'ta ndin më flet e shkruan krejt çka di.

Kur në nëntor 2018 shkova në stacionin policor në Tiranë m'u interesu për procedurat për m'u ba shtetase e Shqipërisë, hasa në do milice me bisteka, musteqoke t'papame, arrogante që kurrësesi s'doishin me më kuptu, por mbas një lufte të madhe në fund lëshuan pe dhe ma printuan një letër me kushtet për shtetësi.

Inati i madh m'ka lënë mbrapa, si dola në oborr të stacionit të policisë, e shqeva atë shit letre dhe e hodha në kantën e mbeturinave të policisë.

Pastaj, fati im shkon edhe më larg:

Në vend se me më thirrë Edi psika mu, ai e thirrë Besa Shahinin, e mua çohet i teket e më thirrë në telefon Rexhep Shahin për me më tregu se kam mbledh miliona gazeta dhe se i pëlqejnë shumë shkrimet e mia, anipse shkruaj kundër Enver Hoxhajt, dhëndrit të tij.

Gruaja e Enver Hoxhajt është doktoreshë e gazetarisë në UP, por me shkru s'din.

Këta janë ato karikaturat që janë ulur mbi varret e të parëve tanë; mbi varret e patriotëve; mbi varret e dëshmorëve dhe mbi varret e viktimitave të tyre; i pëshurrin, i mohojnë, i vrasin për së vrari e ua lëkundin eshnat, kurse në 's'kemi forcë, as s'kemi vullnet t'u hakmerremi'.

Askush s'jeton mbi tre ditë pa vullnet për jetë, përveç me shqiptarët!

Opinioni *i* Ditës

Politikanë pa diplomaci për Ministrinë e Jashtëme

Nga Desada Metaj

I papërgjegjshëm, i papërvojë dhe i pasigurt. Me këtë arsyetim Presidenti Ilir Meta ka refuzuar dekretimin e Genti Cakës në postin e ministrit të Jashtëm të Shqipërisë.

28-vjeçari nga Kosova, që prej ditës së sotme është shndërruar në mollën e re të sherrit në politikën shqiptare. Lindur në vitin 1990 në Kosovë dhe arsimuar kryesisht jashtë Shqipërisë, Caka ka mbajtur prej disa muajsh postin e zv/ministrit të Jashtëm dhe me parë atë të këshilltarit të kryeministrit Rama.

Gjatë muajve që ka qenë numri dy i diplomacisë, Genti Caka nuk është pajisur me certifikatën e sigurisë, një dokument shtetëror që i lejon zyrtarëve të lartë të shtetit të kenë qasje në informacione të klasifikuara si sekrete shtetërore. Ai ka paraqitur kërkesën dhe është pajisur me të një ditë më pas, në



datën 4 janar. Kjo është dhe një nga arsyet, në mos kryesorja që e ka nxitur presidentin Meta të mos e dekretojë atë për ministër të Jashtëm, duke marrë shkas dhe nga interpretimet e një interviste që zoti Caka ka dhënë për gazetarin

Baton Haxhiu në Kosovë.

Madje ky i fundit me anë të një letre i është përgjigjur Presidentit Meta për mosdekretimin, duke i përmendur shkollimin dhe kulturën e ministrit të propozuar nga Edi Rama. Edhe kryeministri nga ana

e tij ka qenë tepër aktiv në reagimet post mosdekretimit, duke i dhënë përgjigje jo vetëm Presidentit, por dhe disa politikanëve në Kosovë që kanë përsëndetur aktin e Ilir Metës.

Në këto kushte, kur Presidenti

nuk ka ç'dekretuar ende ministrin Ditmir Bushati nga detyra, kur ka hedhur poshtë dekretin për Genti Cakën, në mungesë të Gjykatës Kushtetuese, Shqipëria ndodhet përballë një ngrerç në përfaqësimin e saj diplomatik, ndërkohë që është edhe përballë sfidave të rëndësishme siç është hapja e negociatave apo roli i saj në bisedimet Kosovë-Serbi.

Ndoshta zhvillimet politike në vend, protesta e studentëve, lëvizjet e ministrave apo dhe pakënaqësitë e brendshme brenda mazhorancës kanë qenë forca lëvizëse për të kundërshtuar emërimin e ministrit të ri të Jashtëm, një djali të ri dhe të mirëformuar që mbase i duhet të kuptojë se në Shqipëri prodhohet më shumë politikë se diplomaci. Dhe se politika gjithsesi prevalon jo vetëm mbi diplomacinë, por dhe mbi vlerat apo njerëzit që ndoshta vërtetë duan të kontribojnë për vendin e tyre./Opinion.al

Opinioni *i* Ditës

Nga Arian Galdini

Presidenti i përbashkët dhe ministri i Jashtëm!

E gjitha ka nisur me dronin. Po po. Kthehuni pas e kujtoni patriotizmin tallava që lindi pas atij droni në stadiumin e Beogradit.

Ajo ishte karamelja e parë e planit që po niste të zhvillohej.

Vijoi me konferencën për shtyp të Ramës me Vuçiqin në Beograd.

Lufta laboratorike e shpallur mediatikisht dhe e nisur me top futboll mes Ramës dhe Vuçiqit ia doli të prekte mendjet dhe zemrat e çdo tifozit kuqezi e çdo shqiptari pa mendim.

Kjo ishte karamelja e dytë. Treni rus ishte po ashtu pjesë e "trailerit" i përsosur që paralajmëroi ardhjen në skenë të filmit thriller "Shkëmbimi i Kufijve" me autorë të njohur e me aktorë kryesorë Presidentin Vuçiq, Kryeministrin Rama dhe Presidentin Thaçi.

Kur Kryeministri Edi Rama mbajti fjalimin e tij përshëndetës për 10-vjetorin e Pavarësisë në Kuvendin e Kosovës, hodhi një tjetër karamelë për patriotët tallava.

Ai foli për Presidentin e Përbashkët mes Shqipërisë dhe Kosovës.

Disa e quajtën lajthitje, disa përdorim, disa folklorizëm, etj., etj... Sot kuptohet se nuk paska qenë rastësi aspak, por paskërka qenë pjesë e skenarit.

Ndërkohë Rama i kishte bërë edhe disa akte që e ushqenin fort intrigen dhe spekulimin e një par-



adigme kinse patriotike, sepse kish të emëruar diss zv/ministra nga Kosova në Qeverinë e tij të Rilindjes.

E ja ku erdhi më pas dita kur Presidenti shpalli idenë e tij për një marrëveshje historike Kosovë - Serbi që kërkon sakrificën madhore të shkëmbimit të kufijve.

Guximi i Thaçit shkoi drejt të paimagjinueshmes, ngase ai jo vetëm bëri publike një ide a mundësi, por ia nisi një fushatë që vijon edhe sotdita për t'i bindur liderët e Perëndimit se e vetmja marrëveshje e mundshme dhe realiste që mund të arrihet mes Kosovës dhe Shqipërisë është ajo që pranon

domosdoshmërisht shkëmbimin e kufijve.

Rast i rrallë në botë që një President bën fushatë për të bindur të mëdhenjtë e botës se cenimi i integritetit territorial të vendit të tij është ide e mirë.

Asokohe Ditmir Bushati papritmas foli për idenë e shkëmbimit të territoreve si një hapje të kutisë së Pandorës.

Ndërhyrja e Ditmir Bushatit me shumë gjasa ka qenë jashtë dijenive të Thaçit dhe Ramës e i ka zënë të dy këta gafil, por edhe autorët e skenarit të filmit të tyre thriller për të cilin kishin investuar aq shumë luftë e përpjekje labo-

rorike.

Prej kutisë së Pandorës së Bushatit, Edi Rama u dënua me hesh-tje të gjatë dhe u paralizua e gjithë kavalieria e tij mbështetëse propagandistike e parashikuar sipas planit në krah të Thaçit.

Gjithsesi u desh rrëmbimi i duarve të Ramushit dhe ajo foto mbi flamurin kuq e zi, që Edi Rama, i fshehur pas shpatullave të Kryeministrit të Kosovës, me hile si gjithmonë të rikthehej në rolin e tij të detyruar si pjesë e planit për shkëmbimin e kufijve.

Prej asaj dite mori udhë edhe hapi i radhës që do të sillte shkarkimin e Ditmir Bushatit dhe emërimin e një ministri të ri që vjen si pjesë e kastit të përzgjedhur për filmin thriller "Shkëmbimi i Kufijve".

Karamelja për patriotizmin tallava ishte ardhja e ministrit të ri nga Kosova.

Qëllimi i vërtetë ishte sjellja e një ministri që është partizan i planit për shkëmbimin e kufijve.

Nuk kam fare asnjë mendim e asnjë konsideratë personale për Genti Cakaj, sepse as e njoh e as di kurrgjë për të.

Por vetë fakti që ai vjen si pjesë e një kastit të një filmi tepër të rrezikshëm për Shqipërinë, Kosovën, shqiptarët, shqiptarinë, mua më

mjafton për ta përshëndetur mosdekretimin e tij nga Presidenti Ilir Meta.

Genti Cakaj mund të jetë djali më i mirë dhe më i talentuar në botë, e madje edhe më i lexuari ndër gjithë shqiptarët.

Ama, kjo nuk e kualifikon atë për t'u bërë ministër i Jashtëm i Shqipërisë që pranon shkëmbimin e kufijve të Kosovës me Serbinë, thjesht dhe vetëm pse ai ka shtangur Edi Ramën me dijet e tij dhe numrin e librave që mund të ketë lexuar.

Edi Rama mund ta mbajë këshilltar e të mahnitet çdo ditë me Gentin, e deri këtu nuk ka kush t'i kërkojë llogari.

Sa për të drejtën e tij si Kryeministër, që të emërojë kë të dojë si Ministër të qeverisë së tij, i duhet më parë ta besojë edhe vetë se dekretet nuk i firmos Presidenti i Republikës së Shqipërisë Ilir Meta, por Presidenti i Përbashkët Imaginar i Thaçit dhe Ramës që quhet Baton Haxhiu.

Nëse Ilir Meta si President i Republikës nuk paskërka të drejtë të fusë hundët në kompetencat e Kryeministrit për të zgjedhur Ministrat e do, atëherë çfarë të drejte kushtetuese ka Presidenti i Përbashkët Baton Haxhiu që emëron ministrin në qeverinë e Edi Ramës?

Opinion i Ditës

BE dhe sfidat e marrëveshjes Brexit

Nga Geron Kamberi

(vijon nga faqja 1)

... e britanikëve vendosën që vendi duhet të largohet nga Bashkimi Europian pas gati 45 vjetësh anëtarësimi. Në këtë rast vlen aforizmi se 'vezën e zier është e vështirë ta bësh të pazier' dhe zbatimi i Nenit 50 të TFEU (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Europian apo siç njihet Traktati i Lisbonës) që lidhet me largimin e një vendi anëtar nga Bashkimi Europian do të ishte eksperiencë jo e lehtë. Bashkimi Europian nuk e priti mirë këtë vendim të Britanisë, por parimi se në demokraci vendos shumica vulosi çdo diskutim të mëtejshëm.

Teksa Britania njoftoi zyrtarisht Komisionin Europian për t'u tërhequr më 29 mars 2017, sipas Nenit 50 kjo nënkuptonte fillimin e një periudhës 2-vjecare negociatash për marrëveshjen e largimit (angl. EU withdraw agreement) çka e shndërronte 29 marsin 2019, si afatin zyrtar të largimit të Britanisë nga BE, nëse nuk do të kishin të zgjatje përtej këtij afati. Qeveria britanike krijoi një ministri të re për këtë qëllim, Departamenti për Largimin nga BE (Department for Exiting of the European Union) dhe në tavolinën e negociatave mes BE e Britanisë u shtruan për diskutim një sërë çështjesh, që nuk do të rezultojnë të lehta për t'u kapërcyer. Në të përfshiheshin të drejtat themelore të qytetarëve të BE-së në Angli e atyre të Anglisë në BE, detyrimet financiarë që Anglisë për BE në kuadër të 2014-2020, çështja e regjimit kufitar mes Britanisë e Irlandës, duke pasur parasysh se pjesa e Irlandës së Veriut që i përket Britanisë ka kufirin e vetëm tokësor me Republikën e Irlandës, vend anëtar i BE.

Për këtë arsye ishte e natyrshe që David Davis, sekretari britanik për Brexit dhe Michel Barnier, kryenegociatori i BE, i caktuar nga Komisioni Europian për këto negociata u shndërruan në pika referimi lidhur me çështjet e mësipërme. Nëpërmjet letrës së kryeministres britanike të 29 marsit 2017, drejtuar BE-së, ku njoftonte zyrtarisht për largimin e Britanisë nga BE si rezultat i referendumit, Britania përcaktoi edhe 7 parimet e negociatimit, duke synuar një marrëveshje sa më lehtësuese. Por, negociatat u shtynë për shkak të zgjedhjeve Britanike të 8 qershorit 2017 me idenë se do të sillnin një qeveri të qëndrueshme negociatore në Angli. Në të vërtetë ato prodhuan një maxhorancë të brishtë për May, që do të varej nga votat e Partisë Demokratike Unioniste të Irlandës së Veriut, e cila si rrjedhojë do të merrte një rol përcaktues për aspekte të veçanta të marrëveshjes, që lidheshin veçanërisht me raportet e Irlandës së Veriut me Irlandën si vend anëtar i BE. Në këtë kuadër, BE ia bëri të qartë Britanisë se nuk iu la të zgjedhë në bazë të parimit



të vjeljes së qershive-cherry-picking (të zgjedhë nga pema ato kokrra që do) pra, nëse do të vazhdohte të merrte pjesë në Tregun e Përbashkët Europian, do të merrte pjesë me të gjitha të drejtat e detyrimit. Ashtu siç parashikohet, BE dhe Britania u përfshinë në procesin negociatash me 3 faza gjatë periudhës 29 mars 2017-14 nëntor 2018, por draft-marrëveshja me 611 faqe, ku 585 faqe flasin për detyrimet ligjore të Britanisë në raport me BE-në sollën stuhitë politike brenda Britanisë. Theresa May, që kishte parashikuar ta kalonte marrëveshjen për miratim në 11 dhjetor 2018 në Parlament u step dhe një sërë dorëheqjesh pasuan, duke përfshirë dy sekretarët për Brexit, David Davis dhe Dominic Raab dhe një sërë ministrash që e konsideruan këtë draft-marrëveshje të pafavorshme për Britaninë.

Kjo situatë solli si pasojë faktin se tashmë Britania është përballë skenarit të mosmiratimit të draft-marrëveshjes gjatë mesit të muajit janar 2019 në Parlamentin britanik, që është arritur pas një procesi të gjatë e të vështirë negociator, por që ka pasur shumë "viktima" politike nga ana e Britanisë për shkak të kundërshtimit mbi termat e saj. Mosmiratimi nga Parlamenti britanik në mesin e muajit janar 2019 do të sillte si pa-

sojë një dalje të Britanisë nga BE pa një marrëveshje (apo siç njihet, no deal scenario) çka do të rezultonte në përshtjellime të mëdha pas datës 29 mars 2019. Ndonëse kjo situatë mund të krijonte iluzionin se Parlamenti anglez mund të kishite mundësi të ushtronte ndikim për ta ndryshuar atë, pasoja e vetme do të ishte një mocion mosbesimi dhe zgjedhje të parakohshme në Britani që nuk do të bënin as opozitën laburistë të Jeremy Corbyn-it. Për këtë arsye kryeministria Tereza May u ka bërë të qartë deputetëve britanikë se mosmiratimi do ta vinte në pozitë akoma më të vështirë Britaninë. Ndërsa miratimi do t'i jepte kohë Britanisë në një periudhë tranzitore 2-vjetore të qëzonte sërish të drejtat e pjesëmarrjes në tregun e përbashkët apo lëvizjes së lirë, me përjashtim të humbjes së të drejtës së votës si shtet anëtar. Gjatë kësaj periudhe tranzitore 2-vjecare, 2019-2021, Britania do të kishte mundësi të negocionte një marrëveshje të tregtisë së lirë me BE, ku siç thotë negociatori i BE, Mishel Barnier ka rëndësi "të diskutohen sesa do të menaxhohen nga të dyja palët, veçanërisht ato elementë që do të jenë të ndryshëm dhe jo ato që do të jenë të përbashkët".

Britania aktualisht kontribuon me 20 miliardë euro në buxhetin e

përbashkët të BE-së, ka 71 deputetë në Parlamentin Europian dhe bashkë me Gjermaninë, Francën, e Italinë është vendi që ka numrin më të lartë të votave (29) në Këshill, ku miratohen legjislacioni e shumë vendime të rëndësishme për funksionimin e BE. Largimi i Britanisë do të krijojë boshllëk në elementët e sipërpërmendur dhe BE do të përpigjet ta mbushë atë. Por, frika që mbizotëron është mungesa e 'po'-së nga Parlamenti britanik, çka do të linte pezull dhe të ngrirë një proces që do të kishte pasojë në mirëfunksionimin e marrëdhënieve mes Britanisë e BE. Deri tani Britania si anëtare e BE ka qenë pjesë e Tregut të Përbashkët Europian dhe Bashkimit Doganor duke përfutur nga hapësira unike për shkëmbimin e mallrave kundrejt zbatimit të katër lirive të lëvizjes, që është themeli bazë i saj.

Aktualisht Britania 44% të eksporteve dhe 53% të importeve i zhvillon me bllokun ekonomik prej 573 konsumatorësh të BE. Si pjesë e Bashkimit Doganor me BE, Britania ka qenë pjesë e sistemit CET-Tarifat e Jashtme të Përbashkëta - Common External Tarifs, sistem i taksave doganore për mallrat e importuara jashtë BE për 6,000 produkte të ndryshme.

Këto tarifa vendosen nga BE dhe çdo vend anëtar është i detyruar t'i zbatojë për sa kohë është pjesë e tij. Tarifat më të larta që ka vendosur BE janë për produktet ushqimore që futen nga jashtë BE, me qëllim të mbrojtjes këto produkte të vendeve anëtare si psh., pijet me 11% apo ato të produkteve të tjera që janë më të larta si psh., vera 12% mishi i vicit 20%, sheqeri 24% gjalpë e djathi (40%) produkte që vinë vende të tilla si Argjentina, Australia. Ideja që Britania të dalë nga Tregu i Përbashkët Europian, por të qëndrojë brenda Bashkimit Doganor me BE sic janë disa vende joanëtare si psh., Turqia apo Andorra do t'ia lehtësonte administrimin e tregtisë ndërkufitare, por do ta përfshinte Britaninë tek sistemi i CET - Tarifit e Jashtme të Përbashkëta - Common External Tarifs, çka do ta ndalonte atë të hartonte e negocionte marrëveshje tregtare me vende joanëtare të BE si psh., Kina, India, Australia etj. Ndërsa, prania në Tregun e Përbashkët të BE që funksionon që prej Traktatit të Mاسترhitit të vitit 1992 dhe është arritja më domethënëse ekonomike e BE nënkupton nga çdo vend anëtar zbatimin e katër lirive të lëvizjes së lirë brenda BE, ku përfshihen 1) mallrat 2) kapitale 3) shërbimet 3) njerëzit. Zgjerimi i këtyre lirive është qartësuar përmes një sërë vendimesh të Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

Nëse Britania do të synonte të rrinte brenda Tregut të Përbashkët, kjo nënkupton zbatimin e katër lirive, përfshirë parimin e lëvizjes së lirë së njerëzve në tregun e përbashkët të punës së BE. Por, zbatimi i këtij parimi solli në Britani pakënaqësinë e qytetarëve britanikë për valët e punëtorëve nga vendet e EQL, që tashmë ishin pjesë e BE. Mungesa e një marrëveshjeje për shkak të mosmiratimit nga Parlamenti britanik do të krijonte problem, pasi nënkupton largimin e Britanisë nga Tregu i Përbashkët dhe Bashkimi Doganor pa përcaktuar de- ➔

Nr	Numri total votuesve	Numri total i votuesve pjesëmarrës	Votat pro(daljes-leave EU)	Votat kundër(daljes-remain in EU)
I. Britania	46,500,001	33,577,342(72.1 %)	17,410,741(51.89 %)	16,141,241(48 %)
I.1. Anglia	39,005,781	28,477,666(73.01 %)	15,188,406(53.38 %)	13,266,996(46.6 %)
I.2. Wellsi	2,270,272	1,628,054(71.71 %)	854,572(52.53 %)	772,347(47.47 %)
I.3. Irlanda e Veriut	1,260,955	790,523(62.69 %)	349,442 (44.22 %)	440,707(55.78 %)
I.4. Skocia	3,987,112	2,681,179 (67.25 %)	1,018,322(38 %)	1,661,191 (62 %)

*Rezultatet e votimit të referendumit të Britanisë për daljen nga BE-UK 'Electorat Commission'

Dështojnë bisedimet me Kuame

Partizani mendon për Kulibali, Gega është kundër

Zvarriten bisedimet me Kuame Karikari, që duket se po joshet nga një pistë arabe, e cila i garanton të paktën dyfishin e pagës që ofrojnë të kuqtë. Ndaj Partizani bën gati një sulmues tjetër për majën e ofensivës. Ganezi i shumëpërfolur i Nefitçi Bakut duket një pistë e ezauruar tashmë, teksa mësohet se janë azerët ata që duan të përfitojnë maksimalisht nga shitja e



Karikarit, pasi arabët janë të gatshëm të paguajnë kartonin e lojtarit, kontrata e të cilit me Nefitçin përfundon në qershor të këtij viti. Duke parë këtë situatë, të kuqtë janë futur menjëherë në bisedime me sulmuesin nga Guinea-Bisau, Ide Kulibali. Ky i fundit është përfolur vitin e kaluar edhe si

përforcim i mundshëm i Kukësit, por duket se në Shqipëri do të vijë për llogaritë të Partizanit. Me lojtarin është arritur në parim akordi financiar, por palët duhet të ulen edhe një herë për të konkretizuar gjërat. Kulibali është një qendër-

sulmues tipik, i cili ka luajtur edhe për Boavistën në Portugali. Por në këtë mes ka një tjetër këqkë. Trajneri Gega nuk është aspak i bindur për këtë lojtar dhe nuk e ka miratuar blerjen e tij, çka ka bërë që firma të qëndrojë pezull për momentin.



Operohet Bregu, rikthehet në mesin e muajit shkurt

Dejvi Bregu i nënshtruhet operacionit pas dëmtimit të pësuar në miqësoren që Skënderbeu zhvilloi ndaj Tiranës. Vlonjati i korçarëve pësoi një frakturë në pjesën e sipërme të krahut të djathtë, duke bërë që lojtari të humbasë fazën përgatitore. Pas vizitave më të detajuara mjekësore, 23-vjeçari i është nënshtruar operacionit, i cili ka dalë me sukses. Mjekët e kanë siguruar Dejvi Bregun që rikuperimi i tij varion nga 3 deri në 5 javë, duke bërë që lojtari të humbasë tri javët e para të fazës së tretë, për të qenë në dispozicion të plotë të trajnerit Orges Shehi vetëm nga mesi i muajit shkurt. Dëmtimi i sulmuesit të krahut erdhi në momentin më të mirë për të, pasi futbollisti kishte nisur në mënyrën e duhur fazën përgatitore dhe shihet si një pikë referimi për skuadrën e Skënderbeut. Jo vetëm në aspektin individual, por edhe për kampionët mungesa e tij do të ndihet shumë në fushën e lojës, duke qenë se deri më tani vlonjati i sulmit bardhekuq ka shënuar plot 7 gola (golashënuesi më i mirë i skuadrës dhe një garë për të fituar Këpuçën e Artë). Gjithashtu Bregu është një nga lojtarët më të rrezikshëm në repartin e avancuar me lojën e tij, duke dhënë edhe shumë asiste për shokët e repartit.

Konfirmohet shitja-surprizë në Bjellorasi e Amadu Latif, pritet bullgari Radoslav Valisev

Hasanbelliu: Teuta do jetë super, Gjici do të dalë vetëm i pesti!

Presidenti i Teutës ngacmon homologun e tij të Kukësit



Jeton Selimi

Skuadra e Teutës kërkon të bëhet protagonist kryesor në futbollin e vendit tonë dhe synon që të luftojë jo thjesht për Europën, por edhe për titullin kampion në këtë sezon. Kjo konfirmohet edhe më shumë nga lëvizjet e fundit që po bën ekipi durrsak, i cili mendon të përforcohet në prapavijë, por edhe në sulm, ndonëse për momentin nga aty ka larguar sulmuesin kryesor, Latif Amadu. Konfirmimi vjen nga presidenti i skuadrës durrsake, Edmond Hasanbelliu, i cili në një intervistë për RTSH ka bërë bilancin e merkato të skuadrës së tij në këtë periudhë. "Arapi pothuajse është i Teutës. Ka një ngërç me ekipin e tij në Turqi, sa i përket çështjeve financiare. Ai, bashkë me menaxherin do të bëjë shkëputjen nga klubi ku ka qenë, por me 99% është një lojtar i Teutës. Latif është shitur në Bjellorasi. Prisnim më shumë nga ai kur e morëm, edhe pse e menduam fillimisht një sulmues krah, jo një lojtar në qendër. Ai pati probleme, nuk kishim si të kënaqeshim, ndaj e shitëm. Do të marrim tjetër më të mirë dhe njëkohësisht bëjmë edhe para. Prendojmë të marrim një



bullgar dhe një argjentinas. Ka disa alternativa, por shumë shpejt brenda këtij muaji do të themi se kush do të jetë përforcimi ynë", tha Hasanbelliu në intervistën e tij. Sipas RTSH, sulmuesi për të cilin bëhet

fjalë është bullgari Radoslav Vasilev. Sulmuesi 28-vjeçar, është aktualisht pjesë e skuadrës së Çerno More në kampionatin bullgar, ekip me të cilin ka luajtur 33 ndeshje e ka shënuar 9 gola. Që në vitin 2015

ai ka qenë pjesë edhe e përfaqësueses së Bullgarisë, me të cilën ka luajtur 6 ndeshje duke shënuar një gol, në shtatorin e vitit 2018 kur realizoi atë të fitores 1-0 ndaj Norvegjisë në Ligën e Kombeve.

Edmond Hasanbelliu shfaqet rrallë në media, por kur e bën një gjë të tillë, nuk kursen batutat rreth futbollit shqiptar. Presidenti i Teutës, këtë janar mbush 20 vite në drejtimin e skuadrës durrsake dhe njëherë mirë se si funksionon futbollin në vendin tonë ndaj i pyetur rreth luftës për titullin kampion, ai nuk ka rezistuar pa bërë batutën e radhës. Edhe Teuta është mes rivalëve për titullin kampion, por i pyetur në një intervistë për RTSH se cilën skuadër tjetër do të shihet kampione nëse nuk fitonte ekipi i tij, drejtuesi i durrsakëve ka thumbuar presidentin e Kukësit, Safet Gjici. "Nëse jo Teuta, ta marrë kush ta meritojë. Por unë shoh si kampion Safet Gjicin. E shoh si Safet Gjici kampion, si skuadër është për vend të pestë", tha duke qeshur Hasanbelliu.

KAPITENI ZIKALTËR REAGON

Mauro Icardi është kthyer në temën e ditës në futbollin italian, pas deklaratave të Uanda Nara se sulmuesi argjentinas ishte shumë larg rinovimit me Interin. Futbollisti mendohet se kërkon një rrogë shumë të lartë në krahasim me mundësitë që ka Interi, i ndërgjegjshëm se ka treg kudo në Europë aktualisht dhe ndiqet me interes nga klubet e mëdha. Ai vetë ka shtuar edhe më shumë polemikat me një postim të bërë në rrjetet sociale ku sqaronte pozitën e tij në këtë çështje dhe i kundërvihet lajmeve të shpërndara në mediat italiane. "Dua të qartësoj të gjithë tifozët që lexojnë pseudogazetarë dhe




gazetat "serioze" që shkruajnë pa e ditur apo japin udhëzime për të shkruar pa pasur asnjë ide reale si qëndrojnë faktet, se rinovimi im do të vijë në momentin kur Interi të më bëjë një ofertë korrekte dhe konkrete. Vetëm atëherë do të mund të flitet për rinovimin me vërtetësi, duke lënë pas gënjeshttrat që shpërndahen në këto ditë", ishin fjalët e Icardit në një mesazh të publikuar në rrjetet sociale.

ËSHTË ÇËSHTJE E MBYLLUR


Duke nisur nga vëra, Aron Ramsey do të jetë zyrtarisht një futbollist i Juventusit dhe për këtë nuk ka më dyshime, madje janë publikuar edhe detaje nga kontrata që uellsiani ka nënshkruar me klubin bardhezi. Ai do të transferohet në Torino me parametra zero, duke qenë se i skadon kontrata me Arsenalin, ndërkohë që "Topçinjët" nuk pranuan që ta kalonin që në janar, duke kërkuar 20 milionë euro për shërbimet e tij. Në kontratë, parashikohet që Ramsey të jetë futbollist i Juventusit për pesë vitet

Juve-Ramsey, zbulolohen detajet e kontratës



e ardhshme, duke marrë një pagë të majme pasi do të paguhet me plot 7 milionë paund në sezon ose 140 mijë paund në javë. Ai largohet në këtë mënyrë nga Arsenalin, pas një aventure 10-vjeçare në Londër, duke provuar një eksperiencë të re në Itali. Mesfushori 28-vjeçar do të transferohet në Torino me plot 36 milionë paund, të cilat do të jenë vetëm paga për futbollistin pasi kostoja e transferimit është zero. Së bashku me Matuidin dhe Pjanic, pritet që Juventusit të jetë një nga pretendentët kryesorë për të fituar në Europë, duke qenë se Italinë nuk e diskuton në 8 vitet e fundit.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- 1. Pupi regjisor.
- 5. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve
- 11. Turner aktore.
- 12. Fillojnë festat.
- 13. Skuadër greke.
- 14. Falen pa fe.
- 15. U shkrua nga Gorkij.
- 18. Një sferë për... model.
- 19. Janë bisha.
- 22. Farashtesë për dy.
- 23. Demoni që persekutonte Sarën.
- 24. Stacion i famshëm orbital.
- 25. Mendes regjisor.
- 27. Një rreth i ngushtë miqësor
- 29. Film me Robert de Niro dhe Jean Reno
- 30. Këndohen në opera.
- 32. Eshhtë lajm i vjetër.
- 34. Sharif aktor.
- 35. Martin i Norma Rae.

- 36. Mund të jenë filmi.
- 38. Një jepet për hartim.
- 39. Ami i Maupassant.
- 41. Fundi i Turandot.
- 42. Halli këngëtare.
- 45. Neill i Jurassic park.
- 47. Pineda e Garcia Lorca-s.
- 48. Giorgio stilist

VERTIKAL

- 1. Morisette këngëtare.
- 2. Kilmer aktor.
- 3. Heche aktore.
- 4. Fillojnë tatëpjetën.
- 5. Eshhtë diapozitiv shumë i ndjeshëm.
- 6. Mbyllin spitale.
- 7. Në krye të masave.
- 8. Bëjnë shirit me shi.
- 9. Qe vajza e Tantalit.
- 10. Janë më shumë se dëshira.
- 12. Ishte dekret i sulltanit.
- 15. Qe mbreti i urtë i Pilos.
- 16. Quinn aktor.
- 17. Gasol i NBA.
- 20. Fillojnë garën.
- 21. Një pjesë e reformave.
- 26. Eshhtë si biskotë.
- 28. Mund të jetë karmelitan.
- 29. Sjellin shi.
- 30. Bel i Maupassant.
- 31. Direk pa ekstreme.
- 33. Gjysma e bimëve.
- 34. Mbyllin një motor.
- 36. Eshhtë bitum.
- 37. Fara këngëtare.
- 38. Hanks aktor.
- 39. Stiller aktor.
- 40. Morrison rockstar.
- 42. Fillojnë masat.
- 43. Në krye të tabelës.
- 44. Derisa janë në fund.
- 46. Fund filmi.

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL

- 1. Film i hitchcock.
- 6. Fillojnë premierën.
- 7. Janë legjendat.
- 11. Kush ka... ka zët.
- 12. Thurman aktore.
- 15. Një pjesë e testamentit
- 16. Një pjesë e studimeve.
- 18. Kështu është situata e tensionuar.
- 21. Telefoni në kartëvizitë.
- 22. Eshhtë ngasje.
- 24. Në krye të autoriteteve.
- 25. Mbyllin mbledhjen.
- 26. Pason abetaren.
- 29. Fillojnë aafrimin.
- 30. Cocker këngëtar.
- 31. Bartok kompozitor.
- 33. Tiriac që qe tenis.


- 35. Oxa këngëtare.
- 36. Kalimi në ekstreme.
- 37. U shkrua nga Zola.
- 39. Fise pa fe.
- 40. Eshhtë mballomë.
- 41. I mungon apatikut.
- 43. Një pjesë e medaljeve.
- 44. Një këngëtar lirik.
- 46. Pak torturuese.
- 48. Ka privilegjin e jetës.
- 51. I famshmi Pacino.
- 52. Nasi shkrimtar.
- 53. Janë temperaturat më të ulëta.
- 54. Me pit në box.

VERTIKAL


- 1. Janë enigmatikë.
- 2. Emri i Vivaldit.
- 3. Rrjedh në klepsidër.
- 4. Inicialet e Selleck aktor.
- 5. Fillojnë rubrikën.
- 6. Ishte babai i Prokhit dhe Filomelës.
- 8. Vitet pa kufij.
- 9. Mbyllin kanate.
- 10. U shit për një pjatë thjerza.
- 13. ... e shëndoshë në trup të shëndoshë.
- 14. Moore aktore.
- 17. Rocca aktore.
- 19. Janë përmasa.
- 20. Fund dhjetori.
- 23. Mbyllin krahun.
- 26. Fillojnë kalinin.
- 27. Duhën ruajturi.
- 32. Ishte Europa komuniste.
- 34. Agjenci Kombëtare Lokale
- 38. Berg kompozitor.
- 40. Të parat në Amsterdam.
- 42. Elsa këngëtare.
- 45. Memoria në computer
- 47. Me të nxjerrin trashë.
- 49. Në mes të dhomës.
- 50. Ekstreme kateti.
- 52. Kufijtë e lutjes.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

3	8		2	9				1
		1		5				3
						2	7	
			6			3		
				7				
		9					5	8
					1	9		
9	2	5	3		8		4	
				9	7			8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

2	6	1	4	7	8	5	3	9
3	7	4	2	5	9	1	6	8
5	8	9	6	3	1	7	4	2
4	5	8	3	6	2	9	7	1
6	9	3	7	1	5	2	8	4
7	1	2	8	9	4	6	5	3
8	2	6	9	4	7	3	1	5
9	3	5	1	8	6	4	2	7
1	4	7	5	2	3	8	9	6

Argëtim filozofik

- Unë nuk e kujtoj pse disa njerëz mendojnë se masturbimi nuk është gjë e mirë ... është seks me dikë që e doni.

- Martesa është çmimi që burrat paguajnë për seks, dhe seksi është çmimi që gratë paguajnë për martesë.

- Të qeshësh me gabimet e tua, të zgjat jetën. Për të qeshësh me gabimet e të tjerëve, mund të ta zgvëtojë.

- Nëpunësi civil është ai i cili ka një problem për çdo zgjidhje.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	11		18	3	10		18	2	1	15	20	A	P	A	P	E	K	E	N	D	E	T	
3	2	6	5	3	2	1	5		1	13	1		D	I	A	B	E	T	I		D	E	T	I
21		4	3	5	6	2	1	5		5	10	5	R	A	K	L	K	A	P	E	L	E	T	
1		6	10	1	2	8	11	6	4	1	5		F	E	N	I	M	O	R	E	T	R		
2	13	7		2	1	5	1		1	2	8	11	F		E	K	O	N	O	M	I	A	D	
	19	1	7	3	5	6		15	14		10	6	R	A	T	A	K	E	M	E	T	P	E	
13	3	5		2		5	6	11	1		1	5	A	N	T	E	N	A	A	T	A	A	B	
5	2					21		19	6	2	1	5	N	A	N	T	E	S	T	L	A	R	A	
1	5	7			6	2	8	5	10	8	6		K	N	E		I	I	L	I	R	E	T	
16	8	7	8	17	6	5		1	6		21	6	I	B	A	N	A	K	A	E	T			
6				15	8	5	1	5			18	3	10	B	A	R	I	A	L	E	T	N	E	D
4	3	18	8	7	6			18	6	4	6	7	1	E	B	A	S	T	I	A	F	A	T	I

- Dëshitimi i përgatitjes është përgatitja e dëshimit.
- Egoist: një person që interesohet më shumë për veten e tij se sa për mua.
- Kur dikush ju "vjedh" gruan, nuk ka hakmarrje më të mirë se sa të lejoni atë ta mbaj.

- Mos u mundoni për të kuptuar shoqërinë. Ajo duket njerëzore, por ndryshon vazhdimisht fytyrën
- Gjithmonë kam frikë për të mos humbur njerëzit që dua ... Por unë pyes veten: "Ka njerëz që kanë frikë se do të më humbasin mua"

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Thënie të mençura

